



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
**Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of  
Health**



**Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës**  
**Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute Public Health of Kosova**

## **RAPORTI VJETOR Janar-Dhjetor 2025**

# **INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS**

Prishtinë, Janar 2026

## Përmbajtja

1.	Përmbledhje ekzekutive	1
2.	Rezultatet kryesore	6
2.1	Departamenti i Epidemiologjisë	6
2.1.1	Divizioni për sëmundjet ngjitëse	6
2.1.2	Divizioni për sëmundje jo ngjitëse:	9
2.1.3	Divizioni për programin e zgjeruar të imunizimit:	10
2.1.4	Divizioni për kontrollë sanitare, rezistencë antimikrobike dhe infeksione spitalore	12
2.2.	Departamenti i Ekologjisë Humane	15
2.2.1	Monitorimi i cilësisë së ujit për pije në Kosovë	15
2.2.2	Monitorimi i cilësisë dhe sigurisë së ushqimit	17
2.2.3	Matjet e ajrit në mjediset e brendshme në vitin 2025	20
2.2.4	Mbikëqyrja e kushteve higjieniko – sanitare	20
2.2.5	Aktivitete tjera	20
2.3.	Departamenti i Mikrobiologjisë	21
2.3.1.	Aktivitete tjera	21
2.3.2	Zhvillimi i udhërrëfyesve dhe politikave shëndetësore	22
2.3.3	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional	23
2.4	Departamenti i Mjekësisë Sociale	25
2.4.1	Divizioni për shëndetin e nënës, fëmijës dhe të rinjve	25
2.4.2	Divizioni për Promovim dhe Edukim Shëndetësor	25
2.4.3	Divizioni për mbështetjen e zhvillimit të UK dhe PK dhe cilësisë	27
2.4.4	Divizioni për Moshimin	28
2.4.5	Divizioni për Planifikim dhe Vlerësim Shëndetësor	28
2.4.6	Divizioni për Programe të Veçanta	28
2.4.7	Aktivitetet tjera	28
2.4.8	Trajnimet dhe takimet	29
2.5	Departamenti i Statistikave Shëndetësore	30
2.5.1	Vjetarët statistikor	30
2.5.2	Takime me grupe punuese, pjesëmarrja në punëtori dhe takime	30
2.5.3	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional	33
2.5.4	Përgatitja e të dhënave sipas kërkesës nga MSH/institucionet tjera	33
2.5.5	Monitorimi i raportimit nga institucionet shëndetësore publike dhe private	33
2.6	Departamenti i Buxhetit dhe Financave	34
2.6.1	Menaxhimi i buxhetit	34
2.6.2	Të hyrat vetanake	35

---

2.6.3	Pasqyra e performancës financiare _____	35
2.7	Departamenti i Administratës _____	36
2.7.1	Të përgjithshme _____	36
2.7.2	Logjistika/depo _____	37
2.7.3	Teknologjia informative _____	37
2.8	Divizioni i Personelit _____	38
2.9	Divizioni i Prokurimit _____	39
2.10	Zyra për informim _____	41
2.11	Qendrat Rajonale të Shëndetit Publik _____	41
3.	Sfidat në realizimin e detyrave _____	42

---

## Tabelat

Tabela 1. Nr. rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse/shkaktarëve, 2025 .....	8
Tabela 2. Numri i vizitave sanitare të kryera dhe rezultatet, janar – dhjetor 2025 .....	13
Tabela 3. Vizitat sanitare, sipas regjioneve, janar-dhjetor 2025 .....	14
Tabela 4. Mostrat pozitive sanitare sipas llojit të veprimtarisë, janar-dhjetor 2025 .....	14
Tabela 5. Rezultatet e analizave të ujit për pije sipas rajoneve, Janar-Dhjetor 2025 .....	16
Tabela 6. Mikrobiologjia e ujit Janar-Dhjetor 2025 .....	16
Tabela 7. Laboratori Analitik Inorganik-Uji .....	17
Tabela 8. Analizat bazike/fiziko-kimike dhe periodike sipas objektit ujqor .....	17
Tabela 9. Rezultatet e analizave shtesë për vlerat e Manganit në ujin e pijshëm .....	17
Tabela 10. Bromatologjia e ushqimit 2025 .....	18
Tabela 11. Mikrobiologjia e ushqimit 2025 .....	18
Tabela 12. Laboratori analitik organik .....	19
Tabela 13. Numri i analizave të artikujve ushqimor në laboratorët e ushqimit 2025 .....	19
Tabela 14. Numri i analizave të strishove të sipërfaqeve punuese gjatë vitit 2025 .....	19
Tabela 15. Vizitat për vlerësimin e kushteve higjieniko-sanitare, 2025 (N) .....	20
Tabela 16. Numri i testeve në Departament të Mikrobiologjisë, Janar-Dhjetor 2025 .....	21
Tabela 17. Aktivitetet e promovimit dhe edukimit shëndetësor, janar-dhjetor 2025 .....	26
Tabela 18. Temat e ligjruara për promovim dhe edukim shëndetësor, 2025 .....	27
Tabela 19. Vlera e inkasuar për vitin 2025 .....	35
Tabela 20. Buxheti dhe shpenzimet për kategori Ekonomike .....	35
Tabela 21. Raporti i grumbullimit për vitin 2025 IKSHPK dhe QRSHP-të (€) .....	35
Tabela 22. Raporti i participimit për vitin 2025 IKSHPK dhe QRSHP-të (€) .....	36
Tabela 23. Shpenzimet mujore sipas kategorive ekonomike .....	36
Tabela 24. Ndërhyrjet teknike në kategoritë e shërbimeve të sektorit të TI .....	38

## Grafikonet

Grafikoni 1. Mbulueshmëria e vaksinimit sipas kalendarit të rregullt .....	10
--	----

---

## Shkurtesat

AMR	Rezistenca antimikrobike
AQH	Kujdesi Shëndetësor Cilësor dhe i Qasshëm
AQP	Autoriteti Qendror i Prokurimit
ASK	Agjencia e Statistive të Kosovës
ASHI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
AUV	Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinës
BE	Bashkimi European
CDC	Qendra për Kontrollën e Sëmundjeve Ngjitëse
DE	Departamenti i Epidemiologjisë
DKA	Drejtoria Komunale për Arsim
DMZP	Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik
DSSH	Departamenti i Statistikave Shëndetësore
ECDC	Qendra Evropiane për Kontrollën e Sëmundjeve Ngjitëse
EFISG	Grupi i studimeve për infeksione fungale
EFSA	Autoriteti European për Siguri të Ushqimit
ELDSNet	Rrjeti Evropian i Mbikëqyrjes së Sëmundjes së Legjionelës
EMCDDA	Qendra Evropiane për Monitorimin e Drogave dhe Varësisë nga Droga
ESCIMID	Shoqëria Evropiane e Mikrobiologjisë Klinike dhe Sëmundjeve Infektive
ETC	Konzorciumi European i Trajnimeve
FSK	Forca e Sigurië së Kosovës
GYTS	Hulumtimi i duhanpirjes tek të rinjtë në nivel global
HBSC	Hulumtimi mbi sjelljet e shëndetëshme tek fëmijët shkollor
HBV	Virusi i hepatitit B
HCV	Virusi i hepatitit C
HIV	Virusi i imunodeficiences humane
HPV	Virusi i Papillomës Humane
IHS	Shërbimet Shëndetësore të Integruara
IKP	Indikatorët kyq të performancës
IKShPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
INTERSECT	Hulumtimi mbi traumën e nënave të ndërlidhur me lindjen e fëmijës
IST	Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme
KDSH	Kujdesi Dytësor Shëndetësor
KKUPK	Këshilli Kosovar për Udhërrëfyes dhe Protokole Klinike
KOPF	Fondacioni Kosovar për Popullsi
KPKI	Komiteti Profesional për Këshillim për Imunizim
KPSH	Kujdesi Parësor Shëndetësor
KRU	Kompanija Rajonale e Ujësllësit

KTSH	Kujdesi Tretësor Shëndetësor
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MISP	Shëndetin Seksual dhe Riprodhues në situata emergjente
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
NJSHB	Njësia Shëndetësore e Burgjeve
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetit
OECD	Organizata Europiane për Bashkëpunim Ekonomik
OJQ	Organizata Jo Qeveritare
PCR	Reaksioni i Zinxhirit të Polimerazës
PIVI	Partneritetit për Iniciativat Ndërkombëtare të Vaksinimit
PK	Protokole Klinike
PSO	Procedura Standarde të Operimit
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QOESHP	Qendra Operative Emergjente e Shëndetit Publik
QRSHP	Qendra Rajonale e Shëndetësisë Publike
RKI	Instituti Robert Koch
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SISH	Sistemi Informativ Shëndetësor
SKJ	Sëmundjet Kronike Jo-Ngjitëse
SMSN	Sistemi i Menaxhimit të Sëmundjeve Ngjitëse
STEPS	Hapat për faktorët e rrezikut për SKJ
SHSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
TM	Tremujori
TOC	Karboni Total Organik
TORCH	Toksoplazma, Rubella, Citomegalovirusi, Herpes Simplex virusi
THM	Trehalometanet
UA	Udhëzim Administrativ
UA	Udhëzimi Administrativ
UK	Udhërrëfyes Klinik
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsi
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për fëmijë
UPK	Udhërrëfyesit dhe Protokolet Klinike
WHO-FIC	Organizata Botërore e Shëndetësisë-Familja e Klasifikimeve Ndërkombëtare
WNV	Shkalla Jo-Verbale e Aftësisë Wechsler
ZF	Zona e Furnizimit

## 1. Përmbledhje ekzekutive

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) në periudhën janar-dhjetor 2025 është angazhuar në zbatimin e ligjeve dhe kryerjen e veprimtarisë profesionale, mbi bazën e barazisë, përgjegjshmërisë, të dhënave shkencore dhe analizave profesionale.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025 çështje që janë kryer janë:

- Juridiko-administrative
  - Zbatimi i Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në IKSHPK si dhe procesi i përshkrimeve të reja të punës, kontratave të reja dhe sistematizimit të punëtorëve;
  - Decentralizimi i shërbimeve – Transferimi i aparaturave përkatëse dhe trajnimi për kryerje të mikrobiologjisë së ushqimit në të gjitha regjionet, si dhe kryerje të testit mikrobiologjik TORCH në të gjitha regjionet, angazhimi i epidemiologëve rajonal që të monitorojnë sistemin digjital të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe hartimi i raporteve mujore për raportim në SMSN. Inkuadrimi i stafit rajonal në grupe punuese për dokumente të IKSHPK-së. Përgatitja për vaksinimi me vaksina të trafikut ndërkombëtar që nga viti 2026 të kryhet në QRSHP;
  - Hapja e QRSHP Prishtinë;
  - Miratimi i çmimoreve të shërbimeve në IKSHPK;
  - Kërkesë për ndryshim të Ligjit për Shëndetësi Publike, Rregullores për Pishina dhe revidim të Rregullores për organizim të brendshëm të IKSHPK-së.
- Proceset e punës
  - Kontraktimi i operatorit ekonomik për digjitalizim të librezave sanitare;
  - Kontraktimi i operatorit ekonomik për digjitalizim të arkivit të IKSHPK-së;
  - Kontraktimi i operatorit ekonomik nga ana e MSH-së për digjitalizim të të dhënave për ujin, ajrin dhe ushqimin;
  - Montimi i këndeve të edukimit në IKSHPK dhe QRSHP-të (televizorët, karriget, fletushkat në rafte);
  - Ndryshimi i ndërtesës me ngjyra të veçanta për të shënuar ditën e zemrës, diabetit, HIV-it etj.
- Infrastruktura
  - Rregullimi i kamerave për siguri dhe vendosja e shenjave për prezencë të kamerave;
  - Kontraktimi i kompanisë për pastrim;
  - Rregullimi i laurës dhe i parkingut të IKSHPK;
  - Largimi i materialit me afat të skaduar nga Depoja e IKSHPK-së;
  - Largimi i veturave jashtë përdorimit nga parkingu i IKSHPK-së;
  - Largimi i pajisjeve të pa përdorura nga IKSHPK;
- Personeli
  - Kontrollat sistematike të të punësuarve, për herë të parë;
  - Vlerësimi i rrezikshmërisë në punë, për herë të parë;
  - Janë trajnuar 9 persona në IKSHPK/QRSHP por ende nuk janë licencuar nga MFPT për fitimi të statusit të “ekspertit për siguri dhe shëndet në punë”;
  - Mirënjohje për punëtorët e dalluar të IKSHPK-së për vitin 2025;
  - Punësimi i 10 personave në IKSHPK, QRSHP Prishtinë, Ferizaj dhe Mitrovicë;
  - Evidenca e trajnimeve jashtë vendit dhe raporte nga trajnimet;

- **Bashkëpunimet**
  - Marrëveshje mirëkuptimi me RTK për emisione edukativo-shëndetësore dhe prezencë të shtuar në media në ditët botërore të shëndetit;
  - Marrëveshje mirëkuptimi me ECDC për vazhdim të bashkëpunimit;
  - Marrëveshje mirëkuptimi me ETC-PHHP.
- **Shënimi i 100 vjetorit të IKSHPK-së**
  - Udhëheqja dhe monitorimi i 12 grupeve punuese për aktivitetet e shënimit të 100 vjetorit (logoja e 100 vjetorit, pllakat përkujtimore në Prizren e Pejë, Konferenca Concha Colomer, Shkolla verore e promovimit shëndetësor, dokumentari për IKSHPK, pulla postare, manifestimi qendror më 5 qershor, mirënjohjet për të pensionuarit, aktivitetet sportive me popullatë, albumi i punëtorëve, monografia për IKSHPK, numri revial i Revistës SHËNDETI).
- **Rritja e transparencës dhe komunikimit me publikun**
  - Funkcionalizimi i ueb faqes së re me publikime të ndryshme (vjetarët statistikorë, analiza perinatale, analiza e gjendjes shëndetësore, buletinet epidemiologjike, hulumtime për ajrin etj);
  - Shtypja dhe shpërndarja e kalendarit të IKSHPK-së për 2026.
- **Departamenti i Epidemiologjisë** ka vazhduar mbikëqyrjen e situatës epidemiologjike duke kryer hulumtimin e rasteve, grumbullimin, analizën dhe raportimin e të dhënave epidemiologjike me rekomandime përkatëse, si dhe në bashkëpunim me institucione vendore dhe ndërkombëtare të shëndetit publik. Gjatë vitit 2025 janë raportuar 230,866 raste me sëmundje ngjitëse ose Incidencë 12,954.61/100, 000 banorë. Ky numër i rasteve është më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 me 277,296 raste apo 15,559.94/100,000 banorë.

Me më së shumti raste të raportuara janë Sëmundja e ngjashme me gripin (ILI) me 126,316 raste ose Incidencë 7,087.98/100,000 banorë, percjellë nga Diarea akute me 77,176 raste ose Incidencë 4,330.58/100,000 banorë ku të dyja kanë pësuar rënie në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2024 me (138,825 respektivisht 108,077 raste).

Me qëllim të komunikimit dhe informimit sa më të mirë të publikut, prej funksionalizimit të ueb faqes së re të IKSHPK-së janë publikuar buletinet dhe analizat e ndryshme të situatës epidemiologjike.

Gjatë vitit 2025, Divizioni i Programit të Zgjeruar të Imunizimit (PZI) ka zhvilluar aktivitete për rritjen e mbulueshmërisë së vaksinimit, përfshirjen e vaksinës HPV për të dy gjinitë, menaxhimin e situatës epidemiologjike me fruth, identifikimin e fëmijëve të pavaksinuar dhe vaksinimi catch-up. Kjo periudhë u karakterizua me intensifikim të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, ndërgjegjësim publik dhe trajnime të vazhdueshme për profesionistët shëndetësorë.

Mbulueshmëria me vaksinim sipas Kalendarit të rregullt për dymbëdhjetëmujor 2025, në nivel vendi është 90% (duke llogaritur DTaP1 – 99%, DTAP3 – 90% dhe MMR1 - 82%). Sa i përket vaksinimit në shkolla, klasa e parë 94% (MMR, bOPV, DT), klasa e gjashtë 88% (bOPV, dT), 87% (HPV).

Është hartuar Analiza e sëmundjeve masovike jongojitëse 2023, në bashkëpunim me Departamentin e Mjekësisë Sociale dhe Departamentin e Statistikave Shëndetësore në IKSHPK, si dhe është shqyrtuar zbatimi i rekomandimeve të dhëna.

Janë kryer 44,776 vizita sanitare, nga të cilat 1,796 kanë rezultuar pozitive (4.0%). Numri më i madh i mostrave me rezultat pozitiv është identifikuar në tremujorin e tretë

(557 nga 13,339 vizita të kryera apo 4.2%). Sipas llojit të veprimtarisë, numri më i madh i rasteve pozitive u identifikua në sektorin e furnizimit dhe prodhimit të ujit/lëngjeve, me 53 raste pozitive nga 891 vizita (5.9%), dhe atë të artikujve ushqimorë (prodhim, shitje, shërbim), i cili kishte 1,572 raste nga 35,869 vizita (4.4% e mostrave). Këto shifra sugjerojnë se këta dy sektorë paraqesin rrezikshmërinë më të madhe potenciale për shëndetin publik, krahasuar me sektorët e tjerë të inspektuar.

- **Departamenti i Ekologjisë Humane** Në vitin 2025 në Departamentin e Ekologjisë Humane ka vazhduar monitorimi i ujit për pije, ushqimit dhe ajrit. Totali i mostrave për vitin 2025 në Labororet e Ekologjisë Humane të IKSHPK-së është 7,731 nga të cilat 363 (4.69%) mostra kanë qenë jashtë standardit.

Janë punuar 867 mostra vendore të ushqimit nga të cilat jashtë standardeve ishin 1.50%. Nga këto mostra, mostra jashtë standardit u gjetën në mesin e produkteve të mishit. Po ashtu, janë punuar 170 mostra të kufirit nga të cilat jashtë standardeve ishte 1 mostër.

Sa i përket analizave bazike/fiziko-kimike janë punuar gjithsej 1,919 mostra ku prej tyre 231 kanë qenë jashtë standartit, ndërsa sa i përket analizave periodike janë punuar gjithsej 272 mostra prej të cilave asnjë jashtë standartit.

Është mbajtur trajnimi për punë në Quany Tray dhe MiniVidas për kontrollë mikrobiologjike të ujit dhe ushqimit. Nga data 15 shtator analizat mikrobiologjike të ushqimit mund të punohen edhe në të gjitha QRSHP-të.

Gjatë vitit 2025 janë analizuar 12,620 mostra të ujit prej të cilave 98 % janë në përputhshmëri me vlerat parametrike të UA Nr. 10/2021 dhe 2% janë jashtë standartit. Sipas rajoneve, përqindja më e lartë e mostrave të ujit për pije të cilat kanë rezultuar jashtë standardeve i takojnë rajonit të Ferizajit (4.50%) përcjellë nga rajoni i Pejës (4.40%), ndërsa në rajonin e Gjilanit janë raportuar vetëm 0.1% mostra jashtë standardeve.

Në fund të muajit gusht dhe gjatë muajit shtator të vitit 2025 është ri paraqitur fenomeni i pranisë së manganit në Liqenin e Badocit. Gjatë kësaj periudhe janë marrë gjithsej 258 mostra shitesë për analizë të manganit në ZF-PR03, prej nga furnizohen me ujë të pijshëm banorët e komunave Prishtinë, Hajvali, Çagllavicë dhe Graçanicë. Nga këto mostra, 56.20% kanë rezultuar me vlera të rritura të manganit.

- **Departamenti i Mikrobiologjisë** Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 në total janë kryer 328,515 ekzaminime mikrobiologjike nga të cilat numri më i madh 166,496 ekzaminime mikrobiologjike në Departamentin e Mikrobiologjisë të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës. Sa i përket llojit të shërbimeve mikrobiologjike, numri më i lartë i testeve (49,782) janë kryer në laboratorin për diagnozë të infeksioneve urogenitale, më pastaj në laboratorin për diagnozë serologjike të zoonozave dhe patogjenëve tjerë (22,382).

Laboratori referent për rezistencë antimikrobike i cili funksionon në kuader të laboratorit për diagnozë të infeksioneve të gjakut, LTSH dhe hapësirave tjera sterile ka kryer 2,201 testime konfirmuese përveç mostrave rutinore, laboratorin për diagnozë të infeksioneve urogenitale 49,782 testime.

Diagnostikime për kontrolla sanitare: strisho e hundës 41,961, grykës 41,743, fecesi në cistë dhe parazite 40,954 dhe kultura e fecesit 40,806.

- **Departamenti i Mjekësisë Sociale** ka zhvilluar aktivitete në fushën e shëndetit të nënës, fëmijës dhe të rinjve, promovimit dhe edukimit shëndetësor, udhërrëfyesve dhe protokolleve klinike, cilësisë, shëndetit të të moshuarve, si dhe mbikëqyrjes së planeve të veprimit në promovimin e shëndetit dhe shëndetin publik.

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2025 janë shënuar 13 ditë botërore të shëndetit, me realizimin e 966 ligjëratave me 43,393 pjesëmarrës dhe fushatave me 47,561 pjesëmarrës, gjatë të cilave u shpërndanë 112,821 materiale.

- **Departamenti i Statistikave Shëndetësore** gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 ka vazhduar grumbullimin dhe kontrollën e kualitetit të statistikave shëndetësore nga institucionet shëndetësore publike dhe private në Kosovë të cilat raportohen në Departamentin e Statistikave Shëndetësore në IKSHPK, përkatësisht në Qendrat Rajonale të Shëndetit Publik.

Përgatitja e Raporteve të Statistikave Shëndetësore për 2025 duke përfshirë: të dhënat nga institucionet e KPSH, KDSH dhe KTSH, të dhënat për sëmundje malinje dhe SKJ nga institucionet publike dhe private, përgatitja e raportit të detajuar dhe final të aktiviteteve të kryera të grupit punues për aktivitetin solemn të shënimit të 100 vjetorit të IKSHPK dhe përgatitja e recensionit të Monografisë për nder të 100 vjetorit të IKSHPK.

- **Buxheti:** Departamenti i Buxhetit dhe Financave ka kryer aktivitetet për vitin fiskal 2025 sipas Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike Nr.03/L-048, dhe sipas Ligjit të Buxhetit mbi ndarjet buxhetore për vitin fiskal 2025 Nr.08/L-332.

Buxheti Total për vitin 2025 ka qenë 5,722,089.87€. Janë shpenzuar 95.6% të buxhetit të alokuar për 2025 ndërsa vlera e të hyrave është 988,152.39€ (rritje në krahasim me vitin 2024, 110.09% nga planifikimi i paraparë). Të arkëtueshmet janë zvogëluar në krahasim me vitin 2024, prej 87,080.45 në 56,262.27 €.

- **Divizioni i Burimeve Njerëzore** gjatë muajve janar – dhjetor ka kryer detyrat e rregullta në lidhje me pagat, orët shtesë, personelin, sistemin elektronik të monitorimit të ardhje-vajtjes në punë, deklarin e pasurisë dhe të ngjashme. Detyra të veçanta gjatë këtij viti ishin:

Përmbyllja e procedurave të rekrutimit për tetë (8) Mjek Specialist nga lëmia e Shëndetit Publik, dy (2) Infermierë të përgjithshëm (bachelor), një (1) zyrtar të Teknologjisë Informativë, një (1) Zyrtar i Lartë Ekzekutiv, një (1) Asistent në zyrën e Drejtorit Ekzekutiv, një (1) Zyrtar administrativ-arkëtar për QRSHP Mitrovicë, dhe pozitën e Drejtorit të Departamentit të Mikrobiologjisë.

Duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit Nr.08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregullorës Nr.01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në IKSHPK, janë hartuar përshkrimet e reja të detyrave të punës si dhe janë përpiluar kontrata të reja të punës (300 kontrata të reja).

Hartimi i shkresave përcjellëse në Avokaturën Shtetërore dhe vendosja në sistem për menaxhimin dhe arkivimin e lëndëve gjyqësore të Ministrisë së Shëndetësisë (229 lëndë të reja gjyqësore, përgaditje të padive dhe shkresa tjera përcjellëse, 516 lëndë gjyqësore në modul elektronik).

- **Divizioni i prokurimit** në IKSHPK në periudhën janar-dhjetor 2025 ka përgatitur dhe publikuar dosjet e tenderit dhe përshkrimin e çmimeve për 26 aktivitete të prokurimit. Për të gjitha aktivitetet e inicuar varësisht nga faza e procedurës është bërë hapja e tenderëve, vlerësimi i tyre, njoftimi për dhënie/anulim dhe janë nënshkruar 42 kontrata. Aktivitetet tjera të planifikuara janë në proces e sipër.
- **Zyra për informim** gjatë periudhës janar- dhjetor 2025 aktivitetet kryesore të komunikimit publik përfshijnë 188 publikime në faqen zyrtare, 185 postime në rrjete sociale, 75 intervista,

140 përgjigje për media, dhe 3 kërkesa për qasje në dokumente publike me qëllim të transparencës dhe informimit të vazhdueshëm të publikut.

- **Aktiviteti arsimor** IKSHPK ka vazhduar aktivitetin arsimor, me studime paradiplomike dhe pasdiplomike, ndërsa stafi jonë ka punuar për program të ri të Masterit në Shëndetësi Publike, i cili i është nënshtruar akreditimit dhe është në pritje të rezultateve.
- **Aktiviteti shkencor** Hulumtimi mbi institucionet ekzistuese publike dhe private që ofrojnë trajtim psikosocial për viktimat e krimit gjatë luftës, Hulumtimi GYTS në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta, hulumtimi i pilotimit të platformës digjitale “Patrolla e imunizimit”, hulumtimi “Prania e infeksioneve me HCV dhe HBV te pacientët në hemodializë në Kosovë”, hulumtimi “Caktimi i pranisë së antitropave neutralizues kundër Flebovirusëve të njerëzit në Kosovë”. Përgatitja për hulumtimin INTERSECT-Traumat e lidhura me procesin e lindjes, HBSC – sjelljet e shëndetshme të fëmijëve shkollorë dhe NEATs-vlerësimi i ambientit nutritiv në shkolla. Organizimi i Konferencës së IV-të Rajonale për Promovim dhe Edukim Shëndetësor, Libri Kujdestaria e antibiotikëve në kujdesin parësor shëndetësor, Prof. Lul Raka ka marrë çmimin “Musa Haxhiu” nga OMK për arritje shkencore dhe kontribut ndërkombëtar, si dhe çmimin nga ESCMID - Ambasador i AMR dhe Kampion i vetedijesimit për antibiotikë.

## 2. Rezultatet kryesore

### 2.1 Departamenti i Epidemiologjisë

Departamenti i Epidemiologjisë gjatë periudhës janar-dhjetor, 2025 ka bërë monitorim të vazhdueshëm të situatës epidemiologjike me sëmundje ngjitëse, përcjelljen e epidemive dhe ngjarjeve jo të zakonshme. Departamenti ka kryer hulumtimin e rasteve, grumbullimin, analizën dhe raportimin e të dhënave epidemiologjike me rekomandime përkatëse, si dhe ka bashkëpunuar ngushtë me institucione vendore dhe ndërkombëtare të shëndetit publik.

#### 2.1.1 Divisioni për sëmundjet ngjitëse

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 janë raportuar 230,866 raste me sëmundje ngjitëse ose Incidencë 12,954.61/100,000 banorë. Ky numër i rasteve është më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 me 277,296 raste apo 15,559.94/100,000 banorë, (tabela 1).

Me më së shumti raste të raportuara janë Sëmundja e ngjashme me gripin (ILI) me 126,316 raste ose Incidencë 7,087.98/100,000 banorë, përcjellë nga Diarea akute me 77,176 raste ose Incidencë 4,330.58/100,000 banorë ku të dyja kanë pësuar rënie në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2024 me (138,825 respektivisht 108,077 raste).

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 në Divisionin për sëmundje ngjitëse janë realizuar këto aktivitete:

- Monitorim i vazhdueshëm i situatës epidemiologjike për sëmundjet ngjitëse, përfshirë rastet e hospitalizuara në institucionet shëndetësore;
- Vrojtim aktiv epidemiologjik, hulumtim terreni dhe koordinim i përgjigjes epidemiologjike;
- Mbikëqyrja e sëmundjeve që përhapen me ujë, ushqim, vektorë dhe zoonoza;
- Mbikëqyrja specifike për Sindromën Meningjeale, Hepatitin B e C dhe Tuberkulozin;
- Menaxhimi dhe analiza e epidemive të lajmëruara dhe raportimi i tyre tek autoritetet kompetente;
- Mbikëqyrje mujore e dhuruesve të gjakut, grumbullimi dhe analiza e të dhënave për HIV/AIDS dhe IST;
- Mbikëqyrja e Mpox, hulumtimi dhe monitorimi i kontakteve;
- Monitorimi i situatës epidemiologjike me sëmundjet ngjitëse gjatë kujdestarisë dhe festave zyrtare;
- Përpilimi i buletineve mujore të sëmundjeve ngjitëse, tremujore dhe buletineve të gripit (33 buletineve javore, sezona 2024/2025 dhe 2025/2026);
- Raportim i rregullt përmes platformave digjitale Epipulse, Dublin Declaration dhe ELDSNet;
- Monitorimi i raportimit përmes Sistemit digjital të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse (SMSN) përmes vizitave monitoruese dhe njoftimi i Inspektoratit Shëndetësor përmes 7 raporteve (qershor-dhjetor 2025);
- Mbajtja e Telekonferencës Epidemiologjike- EpiTel (27 takime);
- Mbajtja e Komitetit të Inteligjencës epidemike (3 takime);
- Mbajtja e takimit të Komitetit për Sëmundje ngjitëse (Situata epidemiologjike me Fruth në Kosovë, Rekomandime për menaxhimin e situatës);

- Takime me DShSh, MSh, IKShPK, QRSH, Inspektoratin Sanitar, Klinikën Infektive, QKUK dhe partnerët tjerë kombëtarë;
- Bashkëpunim i vazhdueshëm me ECDC, OBSH, EMCDDA, RKI, për shkëmbim të të dhënave dhe përvojave;
- Pjesëmarrje në një seri punëtorish dhe trajnimesh kombëtare e ndërkombëtare që përfshijnë: mbikëqyrjen e sëmundjeve si Legionella, zoonozat, menaxhimin e epidemive, mbikëqyrjen e patogjenëve respiratorë, përgatitjen për emergjenca, komunikimin e rrezikut dhe menaxhimin e infodemisë;
- Trajnime për përdorimin e programit R dhe R Studio;
- Ushtrime simulimi për QOESH, gjendje qetësie, alerti dhe reagimi;
- Pjesëmarrja e specialistëve dhe specializantëve në shkollë verore dhe programe profesionale ndërkombëtare;
- Punëtori të përbashkëta (DShSh dhe Shëndet publik/MSh, IKShPK, QRShP dhe Operatori ekonomik) me qëllim të avancimit të sistemit SMSN;
- Plane monitorimi për: Projektligjin për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse, Pandemitë me patogjenë respiratorë, Plani për Sigurinë shëndetësore;
- Kontribut në hartimin e Planit për sëmundje të rralla, Planit të mbikëqyrjes gjenomike;
- Hartimi i PSO-së për mbikëqyrjen e influencës, COVID-19 dhe patogjenëve respiratorë;
- Monitorimi, Vlerësimi dhe Raportimi i Sëmundjes së Tuberkulozit për periudhën 10 mujore në SMSN/MODULI i TB;
- Vizita dy ditore e ekipit të ECDC-së në Kosovë, vlerësimi i mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse në Kosovë;
- Aplikimi dhe anëtarësimi i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës në GOARN/ Rrjeti global i alertit dhe reagimit ndaj shpërthimeve, OBSH;
- Aplikimi në GenEpi-BioTrain për valën One Health të trajnimeve;
- Pjesëmarrja në takimin përmbyllës të projektit WASP- RKI;
- Përgatitja e materialeve informuese për parandalimin e fruthit, helmimeve me ujë dhe ushqim si dhe kafshimit nga gjarpërinjtë;
- Pjesëmarrje aktive në dokumentin e Monografisë së IKSHPK-së;
- Pjesëmarrja e epidemiologëve/specialistëve të shëndetit publik me kontribute profesionale në numrin e 100 vjetorit të IKSHPK-së në Revistën Mjeku;
- Pjesëmarrja në Punëtorinë dy ditore të IKSHPK-ës “Të arriturat dhe sfidat e IKSHPK-së gjatë vitit 2025, dhe Plani i hulumtimeve 2026-2028 sipas departamenteve”;
- Angazhimet në pjesën e mbikëqyrjes së specializantëve në stazh.

**Sistemi digjital të Mbikëqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN):** Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka mandat monitorimin e situatës me sëmundje ngjitëse në vend të cilën e realizon në baza mujore dhe i cili përfshihet në Buletinin mujor të sëmundjeve ngjitëse.

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2025, QRSHP-të dhe IKShPK realizuan vizita monitoruese për përmirësimin e raportimit të sëmundjeve ngjitëse përmes SMSN, gjatë të cilave u identifikuan pengesa në raportim, infrastrukturë e dobët dhe mungesë raportimi nga disa institucione. Nga qershori 2025, Inspektorati Shëndetësor është njoftuar për raportim në SMSN përmes raporteve mujore sipas Rregullores nr. 09/2024.

Gjatë procesit të monitorimit mbi raportimin e sëmundjeve ngjitëse përmes SMSN krahasuar me ato me kopje fizike, është vërejtur një rritje e lehtë e raportimit dhe funksionalizimit të këtij sistemi, sipas tremujorëve: (janar- mars me një mesatare prej 1.94%, prill-qershor me një mesatare prej 7.33%, korrik-shtator me një mesatare prej 24.2% dhe tetor-dhjetor me një mesatare prej 24.16%).

**Tabela 1. Nr. rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse/shkaktarëve, 2025**

Sëmundjet/shkaktarët	Janar-Dhjetor, 2025		Janar-Dhjetor, 2024	
	Nr.	Incidenca/ 100,000	Nr.	Incidenca/ 100,000
COVID-19	125	7.01	1,735	97.36
ITPR - Pneumonia/ARI	17,057	957.12	17,646	990.17
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	211	11.84	207	11.62
Sëmundje e ngjashme me gripin	126,316	7,087.98	138,825	7,789.90
Influenca A	629	35.30	300	16.83
Influenca B	405	22.73	41	2.30
RSV	312	17.51	177	9.93
Diarea acute	77,176	4,330.58	108,077	6,064.54
Variçela	4,643	260.53	6,536	366.76
Sindromi meningjeal	165	9.26	155	8.70
EHKK	0	0.00	1	0.06
EHSV	1	0.06	2	0.11
Influenca A	1,056	59.26	1,102	61.84
Infeksionet virale intestinale dhe	90	5.05	93	5.22
Salmonella enteritidis	37	2.08	46	2.58
Adenovirus	21	1.18	21	1.18
Norovirus	0	0.00	3	0.17
Enterovirus	13	0.73	16	0.90
Gastroenterokolitet	792	44.44	764	42.87
Clostridium difficile	18	1.01	0	0.00
E. Coli patogjene	10	0.56	4	0.22
Hepatiti akut A	2	0.11	2	0.11
Hepatiti akut B	23	1.29	40	2.24
Hepatiti akut C	8	0.45	3	0.17
Campylobacter	0	0.00	1	0.06
Morbilli	68	3.82	1	0.06
Parotiti epidemik	18	1.01	32	1.80
Pertussis	29	1.63	209	11.73
Rubella	2	0.11	0	0.00
Tularemia	12	0.67	10	0.56
Bruceosis	40	2.24	55	3.09
Leishmaniazë	3	0.17	1	0.06
Leptospiroza	0	0.00	1	0.06
Sëmundja Lyme	19	1.07	8	0.45
Toxoplasmosis	7	0.39	6	0.34
Echinococcus	3	0.17	5	0.28
WNV	1	0.06	7	0.39
Malarie	0	0.00	4	0.22
Legionella	1	0.06	1	0.06
HIV/AIDS	37	2.08	34	1.91
IST	313	17.56	400	22.45
TB	515	28.90	350	19.64
Giardiaza	56	3.14	30	1.68
Mpox	0	0.00	1	0.06
Entameba histolytica	2	0.11	2	0.11
Infeksionet streptokoksike të gr. A	58	3.25	119	6.68
*Sëmundjet tjera ngjitëse	572	32.10	223	12.51
<b>Gjithsej</b>	<b>230,866</b>	<b>12,954.61</b>	<b>277,296</b>	<b>15,559.94</b>

\*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza

## 2.1.2| Divizioni për sëmundje jo ngjitëse:


- Përgatitja e dy prezantimeve për prezantim para delegacionit nga Tajikistani për HPV vaksinimin në Kosovë;
- Mbështetja për tryezën profesionale për vaksinimin sezonal dhe prezantim lidhur me vaksinimin e punonjësve shëndetësor;
- Trajnimi i gazetarëve për raportim për SJK në mënyrë të përgjegjshme, projekt me IHS;
- Pjesëmarrja në debatin me media lidhur me raportimin për SJK me fokus në diabetin;
- Pjesëmarrja në punëtorinë në Durrës për duhanpirjen dhe produktet e reja. (prezantim dhe inpute në plan veprimi të Aleancës kundër duhanit);
- Vendosja e kontakteve dhe takimi me OECD lidhur me këmbimin e informacioneve dhe të dhënave lidhur me prevalencën e duhanpirjes në Kosovë dhe masat antiduhan në përgjithësi;
- Pjesëmarrja në tryezën për duhanpirjen në Prishtinë;
- Nxjerrja e indikatorëve të sëmundjeve jo-ngjitëse;
- Pjesëmarrja në takimin me IHS Projektin dhe MSh për përmbylljen e projektit për spitalet e shëndetshme dhe diabetin;
- Pjesëmarrja në GP për hartimin e Planit të veprimit për SJK;
- Pjesëmarrja në takimin e GP për hartimin e Planit të veprimit për Promovim dhe Edukim Shëndetësor;
- Pjesëmarrja në panelin e diskutimit për SJK - Diabeti dhe raportimi në media (IHS-IKSHPK-MSH);
- Pjesëmarrja në punëtorinë për Planin e Veprimit për PESH (25-26 nëntor në Pejë);
- Pjesëmarrja në punëtorinë për Planin për Sëmundje Jo Ngjitëse Kronike në Istog (12-13 nëntor);
- Raportimi i rregullt mujor për zbatimin e Planit për Siguri Shëndetësore në MSh përmes matricës së monitorimit;
- Raportimi i rregullt për zbatimin e Planit të Avokimit, mobilizimit social dhe komunikimit për vaksinat e reja përmes matricës së monitorimit për MSH;
- Dhënia e inputeve për raportimin për zbatimin e Ligjit për Kontrollin e Duhanit;
- Pjesëmarrja në shënimin e Ditës Botërore të Diabetit më 14 nëntor në Pejë dhe prezantimi: Diabeti në Kosovë-një vështrim epidemiologjik;
- Pjesëmarrja në Programin e Mëngjesit në RTK për temën e Diabetit (14 nëntor);
- Dorëzimi i draft Monografisë së 100 vjetorit të IKSHPK-së (me GP) të Ekipi redaktues pas finalizimit;
- Pjesëmarrja në punëtorinë e organizuar nga MSH -IHS për hulumtimin Kohorta e Sëmundjeve Jo-ngjitëse në Kosovë (KOSCO);
- Pjesëmarrja në emisionin në RTK për Ditën Botërore të HIV/AIDS-it dhe në tryezën e organizuar nga MSH/IKSHPK;
- Inputet dhe komentet në Draft Planin (final) për Sëmundje Jongjitëse Kronike
- Intervistë për RTV Dukagjini për Gripin sezonal;
- Organizimi dhe mbajtja e punëtorisë për draft Planin e Veprimit për RCCE për të gjitha rreziqet me OBSH-në;
- Përcjellja e rregullt e mjekëve në stazh lidhur me modulën e Epidemiologjisë;

### 2.1.3 Divizioni për programin e zgjeruar të imunizimit:

Në vitin 2025 vërehet një përmirësim i dukshëm i mbulueshmërisë së vaksinimit në foshnjëri, veçanërisht për vaksinat e lindjes dhe dozat e para të skemës bazë. Megjithatë, dozat përforcuese dhe vaksinimi i fëmijëve mbi moshën 1 vjeç vazhdojnë të paraqesin mbulueshmëri të pamjaftueshëm, çka tregon vështirësi në vazhdimësinë e skemës së plotë të vaksinimit dhe nevojën për ndjekje më aktive nga shërbimet shëndetësore.

Një shqetësim i veçantë për shëndetin publik paraqitet rënia e mbulueshmërisë së vaksinës MMR në grupmoshën 12–24 muaj, e cila rrit rrezikun për shpërthime të fruthit dhe sëmundjeve të tjera të parandalueshme me vaksinë. Sa i përket vaksinimit të fëmijëve të moshës shkollore, mbulueshmëria me vaksinë është e lartë përfshirë edhe vaksinimin kundër HPV-së. Kjo mbulueshmëri kontribuon ndjeshëm në uljen e rrezikut të përhapjes së infeksioneve dhe në ndërtimin e një komuniteti më të shëndetshëm (Grafikoni 1).

**Grafikoni 1. Mbulueshmëria e vaksinimit sipas kalendarit të rregullt (%)**



#### Përfshirja e vaksinës HPV për të dy gjinitë

- Konferencë për media për lansimin e vaksinimit të djemve me HPV;
- Punëtori 3-ditore me ekipet e vaksinimit për ndryshimet në kalendarin e vaksinimit dhe përfshirjen e djemve;
- 6 trajnime rifreskuese për vaksinat e reja, vaksinat me indikacion dhe mbikëqyrjen e sëmundjeve vaksinëparandaluese;

#### Shënimi i javës botërore të imunizimit:

- Tryezë e rrumbullakët me përfaqësues nga institucionet publike, organizatat ndërkombëtare, OJQ-të dhe profesionistë shëndetësor;
- Takimi në Skënderaj dhe Gjakovë në QKMF për nder të shënimit të javës së Imunizimit;

#### Rritja e kapaciteteve dhe përfshirja e komunitetit:

- Vizita në komunitete vulnerabël (Romë, Ashkali, Egjiptian) për vaksinimin “derë më derë”;
- Takime informuese me prindër, DKA, drejtorë shkollash dhe media;
- Fushata informuese për gripin sezonal dhe vaksinat rutinë përmes videove dhe broshurave.

#### Menaxhimi i rasteve të fruthit:

- Vizita në terren për identifikim, gjurmimin e kontakti dhe vaksinim të fëmijëve të pavaksinuar;

- Rekomandime për institucionet parashkollore me dhe pa raste të konfirmuara;
- Tryeza të rumbullakëta dhe punëtori me akterët institucionalë për kontrollin dhe parandalimin e fruthit;
- Vizitat e përbashkëta IKShPK me inspektorët sanitar në institucionet parashkollore, për hulumtimin e rasteve me fruth si dhe ndërmarrja e masave parandaluese dhe kundërepidemike;
- Rekomandimet e IKShPK-së për Institucionet parashkollore (çerdhe dhe kopshte) me raste të konfirmuar me fruth dhe rekomandimet pa raste të konfirmuara me fruth;
- Komunikatë për media “Thirrje për Vaksinim- Mbrojtja më e mirë kundër Fruthit”;

#### Hartimi i Dokumenteve dhe Planeve të veprimit:

- Udhëzimi Administrativ për imunoprofilaksë dhe kimioprofilaksë, i aprovuar;
- Përditësimi i planit të veprimit për vaksinim 2025-2026, i aprovuar;
- Plani i veprimit për parandalim, kontrollë dhe reagim ngaj situatës epidemiologjike me fruth, i aprovuar;
- Plani i përditësuar i Komunikimit, Avokimit dhe Mobilizimit Social për HPV vaksinën dhe aplikimin e saj edhe te djemtë, i aprovuar;
- Hartimi i draftit parafinal të planit të gatishmërisë për vaksinim në masë në raste të pandemisë me patogjen respirator.

Vaksinimi "catch-up": Me qëllim të rritjes së mbulueshmërisë me vakcina dhe reduktimit të numrit të fëmijëve të pavaksinuar, është zbatuar vaksinimi "catch-up" (vaksinim i vonuar/plotësues).

- Identifikimin e fëmijëve të pavaksinuar apo të vaksinuar pjesërisht, në bashkëpunim me institucionet arsimore, QKMF-të dhe ekipet mobile të vaksinimit;
- Zbatimin e vaksinimit “derë më derë” në komunitete të cënueshme, veçanërisht në komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me fokus në rikuperimin e dozave të humbura;
- Kontaktimi dhe vaksinimi i fëmijëve që kishin munguar gjatë vaksinimit në shkolla;
- Koordinimi me DKA-të, DSMSH-të, drejtoritë e shkollave dhe këshillat e prindërve.

#### Bashkëpunimi ndërkombëtar:

- Vizita zyrtare dhe shkëmbim përvojash me delegacionin nga Taxhikistani për vaksinën HPV;
- Punëtori rajonale “Rritja e Mbulueshmërisë dhe Qasjes së Barabartë në Vaksinim përmes Planeve të Targetuara dhe Qasjeve Ndërsektoriale”;
- Vlersimi PIE (Post-Introduction Evaluation) në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Shëndetësisë (OBSH);
- Punëtori ndërkombëtar Rrjeti i Veprimit të Lidhur për Imunizim (LINKED), temë diskutimi “Inovacione për njohuri më të mira për imunizimin”;
- Trajnime të përbashkëta me partnerë si UNICEF, OBSH, PIVI dhe Instituti Robert Koch.

#### Trajnime dhe ngritja e kapaciteteve:

- Trajnime për vaksinimin sipas kalendarit të rregullt dhe me indikacione epidemiologjike;
- Takimet javore në Ministrinë e Shëndetësisë, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve për sistemin e menaxhimit të stokut farmaceutik (SMSF) dhe integrimi i tij në sistemin e informimit shëndetësor (SISh) me pjesëmarrje të MSh, IKShPK dhe KPSH;
- Trajnimi tre ditorë për SMSF dhe BHIS me pjesëmarrës QRShP, KPSH, policia, FSK;

- Trajnime për përdorimin e platformës R dhe R Studio;
- Trajnime me farmacistë për promovimin e vaksinës kundër gripit sezonal;
- Takime informuese në 7 QRSHP për vaksinimin kundër gripit sezonal, me pjesëmarrës nga QKUK, KDSH dhe KPSH;
- Forumi i parë i Imunizimit të nivelit të lartë në Kosovë “Forumi i Imunizimit”;
- Punëtorja e fundvitit - analiza e mbulueshmërisë së imunizimit gjatë vitit 2025 dhe planifikimi i aktiviteteve për vitin 2026.

Furnizimi me vakcina dhe mbikëqyrja e zinxhirit të ftohtë:

- Gjatë periudhës janar – dhjetor 2025, është siguruar furnizimi me të gjitha vaksinat e parapara në kalendarin e rregullt dhe vaksinat me indikacion, në përputhje me planifikimin vjetor të IKShPK dhe aprovuar nga MSh. Shpërndarja e vaksinave është realizuar në të gjitha komunat e Kosovës, duke u bazuar në kërkesat e tyre dhe planifikimet tremujore. Gjithshtu janë furnizuar NJShB-ve me vaksinën e gripit sezonal. Për të siguruar cilësinë dhe sigurinë e vaksinave, është bërë monitorim i vazhdueshëm i zinxhirit të ftohtë.

Vaksinat e siguruara për vitin 2025 përfshijnë:

- Kalendar i rregullt: PCV (50,000), BCG (30,000), bOPV (30,000), HPV (15,000), Rota (10,000), DT (25,000), MMR (40,000), Td (25,000), HepB pediatrik (40,000), Pentaxim (20,000), Hexaxim (20,000), Hepatit B pediatrik (40,000), MMR (40,000), Td (25,000), PCV13 (50,000), Rotavirus (10,000), HPV (15,000), BCG (30,000), bOPV (75,000) – përfshirë shtesën prej (45.000 dozave të furnizuara në korrik), Td adult (8,000).
- Vakcina me indikacion: Rabiesi (800), HepB adult (8.000), Meningjiti (2,000), Tifoide (300), Ethe të verdha (300), HiB (50), Covid-19 (2,880), Vakcina kundër gripit sezonal (85,000), IPV (1,400), Imunoglobulina e Hepatitit B (68)

Aktivitete të tjera të Divizionit për Programin e Zgjeruar të Imunizimit:

- 22 takime, 6 intervista, 2 trajnime, 1 forum i nivelit të lartë, 2 punëtori, 1 video informuese për gripin sezonal,
- Realizimi i Qarkores Informative Nr. 05/2025 për institucionet shkollore dhe parashkollore,
- Raportim mujor i stokut vaksinal në platformën VIVA dhe Thrive 360,
- Plotësimi i kërkesave për vaksinim të të gjithë qytetarëve të vendit (sipas indikacionit dhe trafikut ndërkombëtar).
- Në IKShPK kanë marrë shërbim 1,528 persona, janë përshkruar 98 kartonë ndërkombëtar si dhe janë administruar këto vakcina: Hepatitit B – 205 , Meningjit 1563, Rabies – 69 , serume rabiesi 3 , ethe te verdha 142 , typhoide 33, HIB – 29 , Bopv- 6, Pneumovax 23 – 41 doza, Prevenar 13- 21 doza, Td adult -9 , Grip sezonal 307, HPV- 7 , IPV- 1 dozë si dhe 5 imunoglobulina të Hepatitit B.

#### **2.1.4 Divizioni për kontrollë sanitare, rezistencë antimikrobike dhe infeksione spitalore**

- Mbikëqyrja sanitare e personave të punësuar dhe personave tjerë mikrobartës në shërbimet të cilat rrezikojnë shëndetin e popullatës nga sëmundjet e caktuara ngjitëse,
- Organizimi i punës në Njësinë për Kontrollë sanitare, realizimi i vizitave sanitare dhe dhënja e rezultateve;
- Planifikimi dhe realizimi i vizitave sanitare në terren për institucionet publike (qendrat e paraburgimit, burgjet, etj) – pranimi i kërkesave dhe caktimi i termineve;

- Këshillimi dhe dhënia e rekomandimeve për institucione, operator ekonomik apo individ;
- Grumbullimi, analiza dhe raportimi mujor dhe periodik për aktivitetin e Shërbimit sanitar në IKShPK dhe QRShP;
- Raportimi i vizitat sanitare të kryera nga QRShP-të (nga janari 2025 raportimi bëhet në bazë mujore);
- Fillimi i raportimit për vizitat sanitare të realizuara sipas veprimtarive në nivel vendi;
- Hartimi i Raportit vjetor për Shërbimin Sanitar dhe Infeksionet spitalore;
- Komunikimi, bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve me institucionet (publike dhe private) dhe personat fizik;
- Puna në komisionin për vlerësimin dhe unifikimin e vulave dhe pajisjen e IKShPK-së dhe QRShP-ve me vula të reja;
- Përshkrimi i detyrave të punës për të punësuarit në Divizionin për Kontroll Sanitar;
- Pjesëmarrja në takimet e Komitetit për Infeksione Spitalore (KIS) të QKUK;
- Raportimi periodik mbi ecurinë e infeksioneve spitalore në QKUK dhe aktivitetet e ndërmarra;
- Dhënia e rekomandimeve KIS për masat e parandalimit dhe kontrollit të infeksioneve spitalore në QKUK;
- Hartimi i Termave të Referencës (ToR) për digjitalizimin e librezave sanitare dhe emërimi i menaxherit të kontratës;
- Pjesëmarrja në takime konsultative me operatorin ekonomik lidhur me digjitalizimin e librezave sanitare;
- Caktimi i nën-domenit për sistemin e digjitalizimit të librezave sanitare dhe dërgimi i kërkesës në ASHI;
- Prezantimi i programit digjital dhe trajnimi i punonjësve të IKShPK-së, QRShP-ve dhe Inspektoratit Sanitar (me nivele të ndryshme qasjeje);
- Dizajnimi i formave për librezën sanitare, rezultatin pozitiv dhe antibiogramin, si dhe plotësimi i pjesës informative për palët që aplikojnë për marrjen e shërbimit;
- Përgatitja e draft-marrëveshjes mes IKShPK-së dhe ARC-së për qasjen në të dhënat e gjendjes civile përmes sistemit të librezave sanitare.

Ka vazhduar mbikëqyrja sanitare e të punësuarve dhe personave tjerë mikrobartës për ato kategori punonjësish të cilët mund të ndikojnë në shfaqjen dhe përhapjen e sëmundjeve të caktuara ngjitëse. Gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2025 në IKShPK dhe QRShP janë realizuar gjithsej 44,776 vizita sanitare, nga të cilat 1,796 kanë rezultuar pozitive (4.0%). Numri më i madh i mostrave me rezultat pozitiv është identifikuar në tremujorin e katërt (557 nga 13,339 vizita të kryera apo 4.2%) (Tabela 2).

**Tabela 2. Numri i vizitave sanitare të kryera dhe rezultatet, janar – dhjetor 2025**

Periudha	TM1		TM2		TM3		TM4		Totali	
	N	%	N	%	N	%	N	%	N	%
Pozitive	365	4.1	438	3.6	436	4.2	557	4.2	1,796	4.0
Negative	8,477	95.9	11,697	96.4	10,024	95.8	12,782	95.8	42,980	96.0
<b>Total vizita</b>	<b>8,842</b>	<b>100</b>	<b>12,135</b>	<b>100</b>	<b>10,460</b>	<b>100</b>	<b>13,339</b>	<b>100</b>	<b>44,776</b>	<b>100</b>

Nga 44,776 vizita të kryera gjatë periudhës janar-dhjetor 75.8 % (apo 38,938 vizita) janë kryer në zyret e pranimit, ndërsa 24.2 % (apo 10,838 vizita) janë kryer në terren. Më së shumti vizita sanitare janë kryer në IKSHPK Prishtinë (18.682 apo 41.7%) nga të cilat 550 (2.9%) kanë rezultuar pozitive, ndërsa më së paku vizita sanitare janë kryer në QRSHP Gjakovë (1,597 apo 1.1%). Më së shumti raste pozitive janë regjistruar në QRSHP Prizren - 363 nga gjithsejt 5,537 vizita të kryera (6.6%) (Tabela 3).

**Tabela 3. Vizitat sanitare, sipas regjioneve, janar-dhjetor 2025**

QRSHP	TM1 – TM4 2025			
	Nr i vizitave sanitare	%	Raste pozitive	%
Prishtinë	18,682	41.7	550	2.9
Gjakovë	1,597	3.6	17	1.1
Pejë	4,723	10.5	276	5.8
Prizren	5,537	12.4	363	6.6
Gjilan	3,198	7.1	120	3.8
Ferizaj	5,729	12.8	330	5.8
Mitrovicë	5,310	11.9	140	2.6
<b>Total</b>	<b>44,776</b>	<b>100</b>	<b>1,796</b>	<b>4.0</b>

Sipas llojit të veprimtarisë, numri më i madh i mostrave me rezultat pozitiv u identifikua në sektorin e furnizimit dhe prodhimit të ujit/lëngjeve, me 53 raste pozitive nga 891 vizita (5.9%), dhe atë të artikujve ushqimorë (prodhim, shitje, shërbim), i cili kishte 1,572 raste nga 35,869 vizita (4.4% e mostrave). Këto shifra sugjerojnë se këta dy sektorë paraqesin rrezikshmërinë më të madhe potenciale për shëndetin publik, krahasuar me sektorët e tjerë të inspektuar (Tabela 4).

**Tabela 4. Mostrat pozitive sanitare sipas llojit të veprimtarisë, janar-dhjetor 2025**

Veprimtaritë	Nr. vizitave sanitare	Nr. rasteve pozitive	%
Prodhim, shitje, përgatitje dhe shërbim të ushqimit	35,869	1,573	4.4
Furnizim dhe prodhim të ujit (lëngjeve)	891	53	5.9
Inst. parashkollore, çerdhe, shkolla	3,378	89	2.6
Qendrat e paraburgimit, burgjet	725	9	1.2
Punëtorët shëndetësorë	2,677	52	1.9
Prodhim & tregtim i barnave, kozmetikë, p.	573	12	2.1
Kujdes higjienik & shërbime estetike jo mjekësore	492	4	0.8
Tjera	171	5	2.9
<b>Nr. total i vizitave sanitare</b>	<b>44,776</b>	<b>1,796</b>	<b>4.0</b>

Sa i përket infeksioneve spitalore, për vitin 2025 kemi pranuar vetëm raportin nga Ekipi për Parandalimin dhe Kontrollin e Infeksioneve spitalore të QKUK, i cili përmban të dhëna mbi klinikat raportuese dhe numrin e infeksioneve (mujore dhe totale) për periudhën janar-tetor 2025. Raporti pasqyron një shkallë të përgjithshme të prevalencës së infeksioneve spitalore prej 1.4%. Kjo shifër është dukshëm më e ulët se mesatarja e vendeve të BE-së (5.5% – 6%) dhe mesatarja e shteteve të rajonit (rreth 4% – 7%). Megjithëse ky rezultat duket i favorshëm, një diferencë kaq e madhe me vlerat ndërkombëtare mund të sugjerojë edhe ekzistencën e nën-raportimit nga disa klinika. Vlen të theksohet se gjatë vitit 2025 nuk kemi pranuar asnjë raport nga institucionet tjera shëndetësore publike dhe private lidhur me infeksionet spitalore.

Aktivitetet tjera:

- Pjesëmarrja në takimet Grupit Punues për rishikimin e Funkcionit Mbështetës Emergjent (Drafti i përfunduar);
- Dhënia e rekomandimeve për KIS lidhur me masat për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve spitalore në QKUK (bazuar në raportin vjetor 2024);
- Takime në MSh lidhur me kërkesën e institucioneve për lirim nga pagesa e shërbimeve të marra nga IKShPK/QRShP;
- Aktivitete lidhur me unifikimin dhe pajisjen e IKShPK dhe QRShP me vula;
- Pjesëmarrja në Ushtrimin simulues me temë: “Ngjarje me Viktima Masive - tërmetet” (MSh);
- Pjesëmarrja online në takimin e ECDC (Rrjeti i institucioneve të kujdesit afatgjatë HAI-Net HALT);
- Përshkrimi i detyrave të punës për të punësuarit në Divizionin për kontrollë sanitare dhe infeksione spitalore;
- Pjesëmarrja aktive në takimet e Komitetit për Infeksione Spitalore të QKUK;
- Hartimi i rekomandimeve për Komitetin e Infeksioneve Spitalore lidhur me masat për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve spitalore në QKUK (bazuar në raportin vjetor 2024);
- Tre intervista në media lidhur me Gripin sezonal, HPV vaksinën dhe Fruthin (RTK, Tëvë 1-“Rritë” dhe Radio Kosovë-podcast);
- Takime në MSh lidhur me kërkesën e disa institucioneve për lirim nga pagesa e shërbimeve të marra nga IKShPK/QRShP;
- Takime me grupin punues për Hartimin e Termave të Referencës për Digjitalizimin e Librezeve sanitare (shërbimit sanitar) - Draft dokumenti i përfunduar dhe i dërguar për rishikim.

## 2.2. Departamenti i Ekologjisë Humane

Në periudhën janar-dhjetor 2025 në Departamentin e Ekologjisë Humane ka vazhduar monitorimi i ujit për pije, ushqimit dhe ajrit. Janë plotësuar detyrimet për planin e monitorimit të ujit, përcjellje dhe monitorimin e ndikimit të toksinëve kimike dhe mikrobiologjike me origjinë nga ushqimi, Eshtë përfunduar aktiviteti i monitorimit në amvisëritë e Kosovës, për vlerësimin e kualitetit të ajrit të brendshëm.

Eshtë realizuar bashkimi i Departamentit të Qendrës së Laboratoreve Testuese dhe Departamentit të Ekologjisë Humane në një Departament të Ekologjisë Humane, në pajtim me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në IKShPK si dhe është bërë ndarja në divizione sipas statutit.

Të gjitha QRShP-ve i është mundësuar fillimi i punës me Quany Tray dhe MiniVidas për kontrollë mikrobiologjike të ujit dhe ushqimit.

### 2.2.1 Monitorimi i cilësisë së ujit për pije në Kosovë

Vlerësimi i cilësisë së ujit për pije realizohet sipas Planit të Monitorimit të përputhshmërisë (neni 9 i Udhëzimit Administrativ 10/2021 “Për Cilësinë e Ujit për Konsum Njerëzor”) i cili

bazohet në ndarje të zonave të furnizimit (47 zona të menaxhuara nga 7 kompani rajonale të ujësjellësit) dhe ekzaminimet laboratorike të ndarë sipas rutinave:

R1- turbullira, klorigjithësi dhe parametrat bakteriologjik

R2- parametrat e analizës bazike kimike

R3- Metalet e rënda, pesticidet, karboni total organik dhe trihalometani.

Gjatë vitit 2025 janë analizuar 12,620 mostra të ujit prej të cilave 98 % janë në përputhshmëri me vlerat parametrike të UA Nr. 10/2021 dhe 2% janë jashtë standartit. Sipas rajoneve, përqindja më e lartë e mostrave të ujit për pije të cilat kanë rezultuar jashtë standardeve i takojnë rajonit të Ferizajit (4.50%) përcjellë nga rajoni i Pejës (4.40%), ndërsa në rajonin e Gjilanit janë raportuar vetëm 0.1% mostra jashtë standardeve (tabela 5).

**Tabela 5. Rezultatet e analizave të ujit për pije sipas rajoneve, Janar-Dhjetor 2025**

Rajoni	R1		R2		R3		Gjithsej		
	N	*NJS	N	*NJS	N	*NJS	N	*NJS	% JS
Prishtinë	1,751	0	927	29	54	1	2,732	30	1.09
Gjilan	1,224	0	1,067	3	29	0	2,320	3	0.1
Gjakovë	689	0	408	2	31	0	1,128	2	0.17
Prizren	880	7	355	4	38	0	1,273	11	0.86
Pejë	1,468	15	721	98	20	0	2,209	98	4.4
Mitrovicë	955	16	344	17	16	5	1,315	38	2.8
Ferizaj	900	68	711	5	32	0	1,643	73	4.5
<b>Gjithsej</b>	<b>7,867</b>	<b>106</b>	<b>4,533</b>	<b>158</b>	<b>220</b>	<b>6</b>	<b>12,620</b>	<b>255</b>	<b>2.0</b>

\*NJS – numri i mostrave me rezultat jashtë standartit, % JS – përqindja e mostrave me rezultat jashtë standartit

Jashtë planit të monitorimit janë realizuar edhe 2,497 mostra të ndryshme të ujit, prej të cilave 2.96% kanë rezultuar jashtë standardeve (tabela 6).

**Tabela 6. Mikrobiologjia e ujit Janar-Dhjetor 2025**

Objekti ujqor	Nr. i mostrave		*% JS
	Gjithsej	*NJS	
Ujësjellës (Pika monitoruese)	1,851	0	0
Puse/Bunare/Shpime	143	43	30.06
Pishina të jashtme dhe të brendshme	50	17	34
Ujëra të ambalazhuar	165	0	0
Të tjera	288	14	4.9
<b>Gjithsej</b>	<b>2,497</b>	<b>74</b>	<b>2.96</b>

\*NJS – numri i mostrave me rezultat jashtë standartit, \*% JS – përqindja e mostrave me rezultat jashtë standartit

Janë punuar 416 mostra me 7,997 parametra në laboratorin analitik inorganik, të gjitha ishin vendore (tabela 7).

**Tabela 7. Laboratori Analitik Inorganik-Uji**

	Uji	Mostra vendore		Mostra nga importi	
	Mostra	Nr	Parametra	Nr	Parametra
1	Ujë nga ujësjellësi	301	6,023	0	0
2	Ujë i papërpunuar	36	628	0	0
3	Ujë i përpunuar	28	529	0	0
4	Ujë alkaline	1	19	0	0
5	Ujë nga burimi	20	365	0	0
6	Ujë nga pusi	15	213	0	0
7	Ujë natyral	6	85	0	0
8	Ujë nga banja	5	95	0	0
9	Ujë i dejonizuar	2	2	0	0
10	Ujë para osmozës	2	38	0	0
	<b>Total</b>	<b>416</b>	<b>7,997</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

Sa i përket analizave bazike/fiziko-kimike janë punuar gjithsej 1,919 mostra ku prej tyre 231 kanë qenë jashtë standartit, ndërsa sa i përket analizave periodike janë punuar gjithsej 272 mostra prej të cilave asnjë jashtë standartit (tabela 8).

**Tabela 8. Analizat bazike/fiziko-kimike dhe periodike sipas objektit ujqor**

Objekti ujqor	Analiza Bazike/Fiziko-kimike			Analiza periodike		
	Nr	*NJS	*% JS	Nr	*NJS	*% JS
Ujësjellës	1,156	129	11.15	28	0	0
Puseta	124	33	26.61	4	0	0
Pishina	39	13	33.33	0	0	0
Ambalazhuar	159	0	0	10	0	0
Të tjera	439	55	12.52	230	0	0
<b>Totali</b>	<b>1,919</b>	<b>231</b>	<b>12.03</b>	<b>272</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

\*NJS – numri i mostrave me rezultat jashtë standartit, \*% JS – përqindja e mostrave me rezultat jashtë standartit

Në fund të muajit gusht dhe gjatë muajit shtator të vitit 2025 është ri paraqitur fenomeni i pranishëm të manganit në Liqenin e Badocit. Gjatë kësaj periudhe janë marrë gjithsej 258 mostra shtesë për analizë të manganit në Zonën e furnizimit ZF-PR03, prej nga furnizohen me ujë të pijshëm banorët e komunave Prishtinë, Hajvali, Çagllavicë dhe Graçanicë. Nga këto mostra, 56.20% kanë rezultuar me vlera të rritura të manganit (tabela 9).

**Tabela 9. Rezultatet e analizave shtesë për vlerat e Manganit në ujqin e pijshëm**

Zona e furnizimit	Gusht		Shtator		TOTAL		
	N	*NJS	N	*NJS	N	*NJS	*% JS
PR03	24	21	234	124	258	145	56.20

\*NJS – numri i mostrave me rezultat jashtë standartit, \*% JS – përqindja e mostrave me rezultat jashtë standartit

### 2.2.2 Monitorimi i cilësisë dhe sigurisë së ushqimit

Në laboratorin e bromatologjisë së ushqimit janë punuar 1,233 mostra të ushqimit nga të cilat shumica (1,069) ishin mostra vendore; prej tyre, jashtë standardeve ishin 2.34% të cilat u gjetën në mesin e ëmbëlsirave dhe kripës. Nga 164 mostra të kufirit, jashtë standardeve ishte 1 mostër ose 0.61 % nga pemët/perimet (tabela 10).

**Tabela 10. Bromatologjia e ushqimit 2025**

Bromatologji		Mostrat e kufirit			Mostrat vendore			Gjithsej		
Mostrat		Nr	*NJS	*% JS	Nr	*NJS	*% JS	Nr	*NJS	*% JS
1.Pijet alkoolike dhe		30	0	0.00	461	0	0.00	491	0	0.00
2. Ketchup		1	0	0.00	7	0	0.00	8	0	0.00
3.Mël mesat	Biber	1	0	0.00	0	0	0.00	1	0	0.00
	Vegete	0	0	0.00	0	0	0.00	0	0	0.00
	Majonez	0	0	0.00	8	0	0.00	8	0	0.00
4.Kafe		3	0	0.00	0	0	0.00	3	0	0.00
5.Çokolatë		0	0	0.00	47	0	0.00	47	0	0.00
6.Bombone		0	0	0.00	0	0	0.00	0	0	0.00
7.Alkool		0	0	0.00	0	0	0.00	0	0	0.00
8.Pemë /perime		26	1	3.85	14	0	0.00	40	1	2.50
9.Produkte qumështi		0	0	0.00	60	0	0.00	60	0	0.00
10. Vaj		5	0	0.00	33	0	0.00	38	0	0.00
11.Vezët		0	0	0.00	0	0	0.00	0	0	0.00
12. Çipsat		13	0	0.00	19	0	0.00	32	0	0.00
13. Kripa		3	0	0.00	9	1	11.11	12	1	8.33
14.Sheqeri		0	0	0.00	3	0	0.00	3	0	0.00
15. Produkte mishi		0	0	0.00	61	0	0.00	61	0	0.00
16. Mielli		4	0	0.00	3	0	0.00	7	0	0.00
17. Ëmbëlsirat		63	0	0.00	290	24	8.28	353	24	6.80
18. Produkte mielli		0	0	0.00	0	0	0.00	0	0	0.00
19. Drithera		0	0	0.00	44	0	0.00	44	0	0.00
20. Të tjera		15	0	0.00	10	0	0.00	25	0	0.0
<b>Gjithsej</b>		<b>164</b>	<b>1</b>	<b>0.61</b>	<b>1,069</b>	<b>25</b>	<b>2.34</b>	<b>1,233</b>	<b>26</b>	<b>2.11</b>

**Tabela 11. Mikrobiologjia e ushqimit 2025**

Mikrobiologji		Mostrat e kufirit			Mostrat vendore			Gjithsej		
Mostra		Nr	*NJS	*% JS	Nr	*NJS	*% JS	Nr	*NJS	*% JS
1.Pije		36	0	0.00	394	0	0.00	430	0	0.00
2. Ketchup		1	0	0.00	5	0	0.00	6	0	0.00
3.Mëlmesa	Biber	0	0	0.00	0	0	0.00	0	0	0.00
	Vegetë	0	0	0.00	0	0	0.00	0	0	0.00
	Majonez	1	0	0.00	9	0	0.00	10	0	25.00
4.Kafe		3	0	0.00	0	0	0.00	3	0	0.00
5.Çokolatë		33	0	0.00	48	0	0.00	81	0	0.00
6.Kremë		0	0	0.00	0	0	0.00	0	0	0.00
7.Alkool		0	0	0.00	0	0	0.00	0	0	0.00
8.Pemë / perime		11	0	0.00	30	0	0.00	41	0	0.00
9. Produkte qumështi		12	0	0.00	163	3	1.84	175	3	1.71
10. Vaj		5	0	0.00	25	0	0.00	30	0	0.00
11.Vezë		0	0	0.00	0	0	0.00	0	0	0.00
13. Detergjent		0	0	0.00	0	0	0.00	0	0	0.00
13. Kripë		0	0	0.00	0	0	0.00	0	0	0.00
14.Sheqer		0	0	0.00	0	0	0.00	0	0	0.00
15. Produkte mishi		6	1	16.6	117	10	8.55	123	11	8.94
16. Miell		0	0	0.00	0	0	0.00	0	0	0.00
17. Ëmbëlsirë		11	0	0.00	8	0	0.00	19	0	0.00
18. Çamçakëz		0	0	0.00	0	0	0.00	0	0	0.00
19. Shampon		0	0	0.00	0	0	0.00	0	0	0.00
20. Të tjera		51	0	0.00	68	0	0.00	119	0	0.00
<b>Gjithsej</b>		<b>170</b>	<b>1</b>	<b>0,59</b>	<b>867</b>	<b>13</b>	<b>1,50</b>	<b>1,037</b>	<b>14</b>	<b>1.35</b>

\*NJS – numri i mostrave me rezultat jashtë standardit, \*% JS – përqindja e mostrave me rezultat jashtë standardit

Në laboratorin e mikrobiologjisë së ushqimit janë punuar 1,037 mostra të ushqimit nga të cilat shumica (867) ishin mostra vendore; prej tyre, jashtë standardeve ishin 1.50% të cilat u gjetën në mesin e produkteve të mishit dhe qumështit. Nga 170 mostra të kufirit, jashtë standardeve ishte 1 mostër ose 0.6 % nga produktet e mishit (tabela 11).

**Tabela 12. Laboratori analitik organik**

Parametrat	Nr i mostrave	Nr i parametrave	*JS
Trihalometanet	275	1,375	0
Mykotoxinat	28	48	0
Aditivët	20	60	5
Formaldehidet	28	224	0
<b>Gjithsej</b>	<b>351</b>	<b>1,669</b>	<b>5</b>

Në tabelën nr.12 janë paraqitur rezultatet nga laboratori analitik organik me një total prej 351 mostrave të punuara dhe 1,669 parametra prej të cilave numri më i madhë i mostrave që janë punuar janë nga trihalometanet (275) ku janë punuar 1,375 parametra.

Në Labororet e Kontrollit të Cilësisë dhe Sigurisë së ushqimit janë realizuar 11,466 analiza për mostra të ndryshme të artikujve ushqimor, prej të cilave 210 (1.83 %) nuk i kanë permbushë normat për konsum. Nga to 9,745 kanë qenë analiza të realizuara për mostrat vendore prej të cilave 200 (2.05%) ishin jashtë standardit, derisa 1,721 analiza ishin mostra të artikujve ushqimor nga AUV prej të cilave 10 (0.58 %) ishin jashtë standardit (tabela 13).

**Tabela 13. Numri i analizave të artikujve ushqimor në labororet e ushqimit 2025**

Labororet e kontrollit të cilësisë	Mostrat nga AUV			Mostrat nga IKSHPK			Totali		
	Nr	*NJS	;%JS	Nr	*NJS	;%JS	Nr	*NJS	;%JS
Lab.Bromatologjisë	820	5	0.61	5,345	125	2.34	6,165	130	2.11
Lab.Mikrobiologjisë	850	5	0.59	4,335	65	1.5	5,185	70	1.35
Lab.Inorganik	3	0	0	5	0	0	8	0	0
Lab.Organik	48	0	0	60	10	16.6	108	10	9.25
<b>Totali</b>	<b>1,721</b>	<b>10</b>	<b>0.58</b>	<b>9,745</b>	<b>200</b>	<b>2.05</b>	<b>11,466</b>	<b>210</b>	<b>1.83</b>

\*NJS – numri i mostrave me rezultat jashtë standardit, % JS – përqindja e mostrave me rezultat jashtë standardit

Në laboratorin e mikrobiologjisë sanitare gjatë vitit 2025 janë realizuar 720 analiza nga strisho të sipërfaqeve punuese të marra nga objektet hoteliere, kuzhina qendrore, objekte shëndetësore prej të cilave në 48 (6.6%) janë izoluar baktere. Nga numri i përgjithshëm i analizave të strishove 568 kanë qenë analiza të realizuara nga mostrat vendore me të cilat IKSHPK ka kontratë bashkëpunimi ose kërkesa individuale prej të cilave 44 (7.74%) jashtë standartit, derisa 152 analiza janë realizuar në mostra të strishove nga Inspektorati Sanitar (IS) prej të cilave 4 (2.63%) jashtë standardit (tabela 14).

**Tabela 14. Numri i analizave të strishove të sipërfaqeve punuese gjatë vitit 2025**

Analiza e strishove të sipërfaqeve punuese								
Mostrat nga IS			Mostrat nga IKSHPK			Gjithsej		
Nr	*NJS	;%JS	Nr	*NJS	;%JS	Nr	*NJS	;%JS
152	4	2.63	568	44	7.74	720	48	6.6

\*NJS – numri i mostrave me rezultat jashtë standardit, % JS – përqindja e mostrave me rezultat jashtë standardit

### 2.2.3 Matjet e ajrit në mjediset e brendshme në vitin 2025

Në 20 amvisërit e Komunës së Prishtinës gjatë vitit 2025 janë bërë matjet e parametrave të benzenit, formaldehideve, NO<sub>2</sub>, CO, CO<sub>2</sub>, T, lagështisë relative dhe PM<sub>2.5</sub>, të cilat janë prezantuar në “Raportin e matjeve laboratorike të parametrave mjedisorë në amvisëritë e Komunes së Prishtinës për vitin 2025”, i cili mund të shkarkohet në ueb faqen e IKSHPK-së.

### 2.2.4 Mbikëqyrja e kushteve higjieniko – sanitare

Në kuadër të vlerësimit të kushteve higjieniko- sanitare janë kryer 169 vizita ne institucione parashkollore, shkollore dhe spitale rajonale në tërë territorin e Kosovës (tabela 15).

**Tabela 15. Vizitat për vlerësimin e kushteve higjieniko-sanitare, 2025 (N)**

Rajoni	Institucione parashkollore	Institucione shkollore	Spitale Rajonale	Gjithsej
Prishtinë	8	2	0	10
Gjilan	17	19	1	37
Gjakovë	0	44	0	44
Prizren	8	3	4	15
Pejë	5	8	4	17
Mitrovicë	4	20	0	24
Ferizaj	12	9	1	22
<b>Gjithsej</b>	<b>54</b>	<b>105</b>	<b>10</b>	<b>169</b>

### 2.2.5 Aktivitete tjera

- Është mbajtur trajnimi për marrjen e mostrave të ushqimit për personelin e QRSHP-ve;
- Është mbyllur jekomformiteti i gjetur nga ana e Drejtorisë së Akreditimit të Kosovës;
- Është realizuar Plani i Monitorimit të ujit për pije;
- I është përgjigjur të gjitha kërkesave të Inspektoratit Sanitar;
- Janë vizituar të gjithë prodhuesit vendorë të cilët kanë kontratë me IKSHPK – në;
- Kemi intervenuar me kërkesë të ECDC në rastet e dyshuara me Legionelë.
- Kemi nënshkruar Marrëveshjen e bashkpunimit me AUV;
- Kemi pasur mbikqyrjen dy ditore nga Drejtoria e Akreditimit të Kosovës (DAK);
- Përcjellja dhe monitorimi i THM, TOC;
- Vizita në Manastirin Ortodoks në Dragancë për shkak të informatës për helmim me Shigatoxin;
- Me 15.12.2025 në IKSHPK është mbajtur trajnimi “Ndotja e ajrit të brendshëm, ngritja e nivelit profesional mbi përdorimin dhe matjet me sensorë”. Trajnimi përfshiu pjesë teorike dhe praktike për vendosjen e drejtë të aparaturave, matjet dhe mundësitë e evitimit të gabimeve gjatë monitorimit dhe analizave krahasimore me standardet e OBSH, BE dhe Agjensionit për Mbrojtjen e Mjedisit (EPA) në SHBA. Trajnimi është zhvilluar me profesionistët shëndetësorë përkatës nga QRSHP Prishtinë dhe QRSHP Gjilan, si dhe ekipën e Laboratorit të parametrave mjedisor, laborator ky i akredituar me ISO 17025.

## 2.3. Departamenti i Mikrobiologjisë

Në total janë kryer 328,515 ekzaminime mikrobiologjike në IKSHPK dhe QRSHP (tabela 16). Numri më i lartë i testeve janë kryer në laboratorin për diagnozë të infeksioneve urogjenitale (49,782) përcjellë nga laboratori për diagnozë të infeksioneve të traktit respirator (26,185) dhe laboratori për diagnozë serologjike të zoonozave dhe patogjenëve tjerë (22,382). Më së shumti ekzaminime janë kryer në Prishtinë (166,496) e më së paku në Gjakovë (13,857). Po ashtu, janë kryer diagnostikime për kontrolla sanitare: strisho e grykës (41,743), hundës (41,961), fecesi në cistë dhe parazite (40,954) dhe kultura e fecesit (40,806).

**Tabela 16. Numri i testeve në Departament të Mikrobiologjisë, Janar-Dhjetor 2025**

<b>Ekzaminimet laboratorike</b>	<b>Ferizaj</b>	<b>Gjilan</b>	<b>Gjakovë</b>	<b>Mitrovicë</b>	<b>Pejë</b>	<b>Prizren</b>	<b>Prishtinë</b>	<b>Gjithsej</b>
Metodat serologjike të aglutinit	76	34	103	47	427	518	2,010	3,215
Diag. i infeksioneve të lëngjeve sterile	88	409	152	101	160	432	859	2,201
Diag. i Zoonozave dhe patogjenëve tjerë	0	5	0	2	10	77	22,288	22,382
Diag. i HIV-it dhe Hepatiteve virale	0	0	0	0	0	0	15,057	15,057
Diag. i infeksioneve me M.tuberculosis	38	13	66	398	0	837	6,364	7,716
Diagnostika molekulare	3	0	74	838	86	13	5,018	6,032
Testet për rezistencë antimikrobike	0	0	0	0	0	0	5,033	5,033
Diag. i infeksioneve urogjenitale	3,912	4,855	2,472	7,308	4,272	7,414	19,549	49,782
Diag. i infeksioneve të traktit respirator	3,397	2,968	2,641	2,707	3,665	2,954	7,853	26,185
Diag. i infeksioneve të traktit digjektiv	302	1,013	611	1,851	673	458	5,935	10,843
Diag e infeksioneve parazitare	2,068	1,187	1,692	2,130	1,073	2,470	3,985	14,605
Ekz. sanitare -strisho e grykës	5,735	1,540	1,577	5,247	3,618	5,527	18,499	41,743
Ekz. sanitare -strisho e hundës	5,735	1,540	1,577	5,247	3,618	5,745	18,499	41,961
Ekz. sanitare – fecesi në parazitë	5,330	1,180	1,446	5,247	4,691	5,235	17,825	40,954
Ekz. sanitare – kultura e fecesit	5,330	1,180	1,446	5,247	4,691	5,190	17,722	40,806
<b>Gjithsej</b>	<b>32,014</b>	<b>15,924</b>	<b>13,857</b>	<b>36,370</b>	<b>26,984</b>	<b>36,870</b>	<b>166,496</b>	<b>328,515</b>

### 2.3.1. Aktivitete tjera

- Aprovimi i 18 Procedurave Standarde të Operimit (PSO) nga MSH;
- Deklaratat e Përkushtimit për përdorimin optimal të antibiotikëve në 23 qendra të kujdesit parësor në Kosovë;
- Dërgimi për aprovim të 26 PSO në MSH;
- Është takuar ekipi i OBSH dhe shqyrtuar të gjeturat preliminare për vlerësimin e kapaciteteve diagnostike të laboratoreve referente mikrobiologjike në IKSHPK;
- Janë mbajtur disa trajnime lidhur me zhvillimin e sistemit të menaxhimit të kualitetit në laborator si: Procesi i vlerësimit të riskut për kontrollë të riskut biologjik;
- Lifleta e vetëdijësimit të pacientëve për përdorimin racional të antibiotikëve;
- Përcjell online zhvillimet në EC-HE-PC-HEALTH të Si përgjigje në kërkesën e OBSH-së EURO janë specifikuar nevojat laboratorike për RT PCR kite për diagnostikë të MPOX;
- Pjesëmarrja në Panelet e Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë (EQA); ECDC Aurora Consortium EQA dhe WHO GISRS EQAP;
- Publikimi i 3 protokoleve të projektit në revista shkencore ndërkombëtare;
- Publikimi i kurrikulës “Kujdestaria e antimikrobikëve në kujdesin parësor shëndetësor” (L.Raka, Sh.Krasniqi, A.Jakupi);

- Shqyrtimi i “Planit për mbikëqyrje gjenomike për patogjenët me potencial pandemik dhe endemik” lidhur me kostimin e aktiviteteve dhe objektivën e tretë që i takon LUV;
- Takim, Shëndeti Seksual dhe Riprodhues në Situata Emergjente, Pakoja minimale e shërbimeve fillestare; IKSHPK;
- Trajnim nga konsulenti i OBSH Gockan Uslu lidhur me reagimin në incident, shfrytëzimin e spill kiteve si dhe praktikatat e mirë për biosiguri;
- Janë inicuar dhe janë në zhvillim e sipër hulumtime shkencore lidhur me “Praninë e infeksioneve me HCV dhe HBV te pacientët në hemodializë në Kosovë” dhe hulumtimi “Caktimi i pranisë së antitropave neutralizues kundër Flebovirusëve te njerëzit në Kosovë”.
- Janë zhvilluar diskutime dhe aktivitete në kuadër të projekteve nga me organizata ndërkombëtare, nga lëmia e Mikrobiologjisë:
  - CDF Kosovë; mbështetje në aparaturë;
  - Centre National de Référence (CNR) des Arbovirus, Faculté de Médecine de Marseille dhe Institute of Specific Prophylaxis and Tropical Medicine, Medical University of Vienn;
  - ECDC; ne kuadër të aktiviteteve të Mikrobiologjisë, me fokus në programin AURORAE;
  - Organizaten Boterore të Shëndetësisë, Kosove;
  - Projektin OneHealthSecure (OHS), Instituti i Pasterit, Paris, Francë
  - Robert Koch Institut, Berlin Gjermani
  - SECID (South-eastern Center for Infectious Diseases), Tiranë, Shqipëri, projekti i Gripit;
- Takime me Komitetin për sëmundje ngjitëse lidhur me shpërthimin e epidemisë së Morbillit,
- Janë mbajtur takime lidhur me organizimin e 100 vjetori të themelimit të IKSHPK-së,
- Vizitë nga konsulenti i OBSH Gockan Uslu në periudha të ndryshme kohore lidhur me praktikatat e mira në biosiguri dhe cilësi,
- Vizitë nga Will Chiang, drejtor biznesi i AITbiotech nga Singapori në laboratorin e tuberkulozit,
- Është realizuar asgjësimi i reagensëve dhe materialit harxhues me afat të skaduar nga Depo Qëndrore,
- Realizim i marrëveshjes në mes IKShPK dhe ShSKUK për dhurimin e pesë (5) pajisje të hemokulturës me qëllim të përmirësimit të diagnostikimit të infeksioneve të gjakut.

### **2.3.2 Zhvillimi i udhërrëfyesve dhe politikave shëndetësore**

Personeli i Departamentit të Mikrobiologjisë ka udhëhequr ose kanë qenë pjesëmarrës aktiv në zhvillimin e një numri të konsiderueshëm të udhërrëfyesve klinik, Procedurave Standarde të Operimit, udhëzimeve administrative si dhe të strategjive kombëtare. Këtu vlen të përmenden:

- Është dorëzuar raporti për nevojën për përditësim të Planit Strategjik Kombëtar për Laboratore 2024-2030;
- Hartimi dhe aprovimi i “Doracakut për Siguri të Cilësisë në Laborator të Mikrobiologjisë”;
- Hartimi i “Planit për Mbikëqyrje Gjenomike për Patogjenët me Potencial Pandemik dhe Epidemik”;

- Hartimi i kurrikulës së trajnimit për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve- moduli bazik; dhe mbajtja e trajnimeve përcjellëse bazuar në këtë kurrikulë në të gjitha spitalet e Kosovës;
- Hartimi i Planit të Veprimit për parandalimin, kontrollë dhe reagim ndaj situatës epidemiologjike me fruth;
- Janë mbajtur dy takime në kuadër të Komitetit ‘‘ Një Shëndet’’;
- Janë mbajtur takime lidhur me organizimin e 100 vjetori të themelimit të IKSHPK-së.
- Miratimi final i Planit të Veprimit për Rezistencën Antimikrobike me qasjen ‘‘Një Shëndet’’, i cili është përgatitur në bashkëpunim mes 3 ministrive të Qeverisë së Kosovës (MSH, MMPHI, MBPZHR) dhe ECDC, EFSA dhe Komisionit Evropian (Kryesues i grupit punues);
- Monitorimi i Planit të Veprimit për Strategjinë kombëtare për laboratore të Kosovës 2024-2026;
- Nisma e projekti shkencor vështrim për AMR/AMS në Ballkanin Perëndimor, të udhëhequr nga Kosova me mbikqyrjen e Tim Walsh nga Universiteti i Oksfordit (koordinatori i projektit);
- Përgatitjet fillestare për librin e Rezistencës Antimikrobike me 30 kontributorë të konfirmuar nga 5 kontinentet (do të botohet në gjuhën shqipe dhe do të shpërndahet gratis);
- Punëtori lidhur me ‘‘Kornizën për mozaikun e mbikqyrjes së patogjenëve respirator’’, Bosne dhe Herzegovinë;
- Raportimi për monitorimin e Strategjisë Sektoriale 2025-2030;
- Shqyrtimi dhe vlerësimi për kostim i ‘‘Planit për mbikqyrje gjenomike për patogjenët me potencial pandemik dhe endemik’’;
- Takime me Komitetin për sëmundje ngjitëse lidhur me shpërthimin e epidemisë së Morbillit;
- Takimi punues për hartimin dhe finalizimin e Doracakut për monitorim dhe vlerësim të Strategjisë Sektoriale Shëndetësore 2025 – 2030;
- Trajnim lidhur me modelin i monitorimit të rezultateve (treguesve) të Strategjisë Sektoriale Shëndetësore 2025 – 2030;
- Trajnim lidhur me monitorimin dhe vlerësimin e Strategjisë Sektoriale Shëndetësore 2025 – 2030;
- UA për ‘‘Kriteret, Procedurart, Masat e Biosigurisë dhe Biosigurimit për transportin e mostrave për qëllime diagnostike të sëmundjeve ngjitëse’’;
- Udhëzimi Administrativ i MSH ‘‘Masat dhe kushtet për sigurinë e pacientit, parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve në kujdesin shëndetësor dhe rezistencën antimikrobike’’;
- Vlerësimi i programeve të Kujdestarisë së Antimikrobikëve në 3 spitale të Egjiptit në kuadër të Global Antimicrobial Stewardship Accreditation Scheme (GAMSAS), The British Society for Antimicrobial Chemotherapy – Londër;

### **2.3.3 Zhvillimi i vazhdueshëm profesional**

- Çmimi nga ESCMID - Ambasador i AMR dhe Kampion i vetedijesimit për antibiotikë; Prof. Lul Raka
- Diagnostikimi Laboratorik për Chickungunya, WHO;

- EFISG takim online: Deadly fungal infection for HIV and non-immunocompromised patients; 02.09.2025; 15:00-16:00;
- Konferenca One Health Week, Universiteti i Gizenit dhe UP;
- Pjesëmarrja në kongresin e ESCMID në Vjenë;
- Pjesëmarrja në takimin vjetor të grupit këshillues strategjik të OBSH për rezistencë antimikrobike;
- Pjesëmarrja në trajnimin online për scale-up- GACD;
- Pjesëmarrje në “Konferenca e IV për Promovim dhe Edukim Shëndetesor” Prishtinë;
- Pjesëmarrje në Konferencën: “Sfidat e diagnozës Mikrobiologjike nga aplikimi i metodave tradicionale te metodat moderne të zbulimit te acideve nukleike” – Tiranë;
- Pjesëmarrje në “Kongresin Ndërkombëtar të Shkencave Mjekësore” në Tiranë;
- Prof Lul Raka; Ligjërues i ftuar në konferencën ndërkombëtare One Sustainable Health-Lion, Francë;
- Prof Lul Raka; Ligjërues i ftuar në Hamburg Sustainability Conference, për perspektivat nacionale të Kosovës në rezistencën antimikrobike nivelin global;
- Prof Lul Raka; Pjesëmarrja në trajnimin për shkencën e sjelljes në përdorimin e antibiotikëve- Entebe, Ugandë;
- Prof.Lul Raka; Ligjërues i ftuar në takimin vjetor të shëndetit publik dhe mjedisit në Tiranë;
- Punëtori mbi unifikimin e raporteve mujore për Departamentin e Mikrobiologjisë, Istog;
- Takim online, MediLab secure; Innovative approaches for pathogen surveillance;
- Takim online, OBSH Diagnostikimi i Etheve Dengue;
- Takimi i 2-të i Partnerëve nga Shqipëria, Serbia, Kosova dhe Maqedonia e Veriut “Zvogëlimi i kërcënimit bioterrorist në Ballkanin Perëndimor për të stabilizuar situatën në lidhje me biosigurinë, me fokus në zbulimin, biosigurinë dhe biosigurinë” Shkup;
- Takimi i Task Forcës së Laboratorit, OBSH;
- Tipizimi i patogjenëve kërpudhorë në epokën gjenomike, OBSH;
- Trajnim për ngritjen e vetëdijes dhe diagnostikimin e zoonozave, One Health Secure, Sete, France;
- Trajnim i organizuar për gjithë personelin për “Vlerësim të rrezikut në vendin e punës” Trajnimi për Siguri dhe Shëndet në Punë;
- Trajnim mbi ISO 15189 standardet, Auditimin e brendshëm, Gokhan Uslu;
- Trajnim për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve;
- Trajnim teorik dhe praktik për izolimin, identifikimin dhe rezistencën antimikrobike të baktereve anaerobe, 17-18 Dhjetor 2025;
- Trajnimi i regjioneve për Diagnostikimin me Chorus, QRSHP Ferizaj;
- Vlerësimi i laboratoreve lidhur në programin për testimin e patogjenëve emergjent nga OBSH;
- Pjesëmarrja në misionin special për ngritjen e kapaciteteve të shëndetit publik në Ukrainë, me ftesë të Columbia University dhe US-CDC; Prof Lul Raka;
  - Trajnimet në 4 qendra të Ukrainës (Kiev, Vinicia, Khmelnetski, Ternopil);
  - Takimet me drejtorë institutesh, spitalesh e laboratoresh në qendrat e sipërcituara;
  - Përgatitja e SOP nacionale për hemokulturat;

- Pjesëmarrja në takimin koordinues të projektit Ballkanik të mbajtur në Podgoricë dhe mbështetur nga Instituti Robert Koh;
- Pjesëmarrja në takimin e bordit editorial të redaksisë “Eurosurveillance” (ECDC), Romë, Itali;
- Pjesëmarrja në takimin konsultativ Gjermani-Ukrainë për sfidat e adresimit të CRE në spitale e Ukrainës, mbajtur në Berlin;
- Laureat i Çmimit “Musa Haxhiu” nga OMK për arritje shkencore dhe kontribut ndërkombëtar, Prof Lul Raka;
- Trajnimet për parandalim e kontrollë të infeksioneve dhe për kujdestarinë e antimikrobikëve, në kuadër të OMK, prof Lul Raka;
- Takimet e Komitetit drejtues dhe atij Këshillëdhënës.

## 2.4 Departamenti i Mjekësisë Sociale

Departamenti i Mjekësisë Sociale ka kryer aktivitetet të cilat lidhen me shëndetin e nënës, fëmijës dhe të rinjëve, të moshuarve, me promovimin dhe edukimin shëndetësor të popullatës, mbështetjen e zhvillimit të UPK-ve, përgatitjet për hulumtimet si dhe aktivitete tjera të përbashkëta.

### 2.4.1 Divizioni për shëndetin e nënës, fëmijës dhe të rinjve

Aktivitetet kryesore në këtë divizion janë përqëndruar në vlerësimin e gjendjes shëndetësore të grupacioneve vulnerable. Aktivitetet kryesore janë:

- Gjatë periudhës raportuese, puna është fokusuar në pjesëmarrje aktive në takime pune për hartimin dhe përditësimin e dokumenteve ligjore e strategjike, përgatitjen dhe shënimin e javës botërore të gjdhënies, përmirësimin e fletëzës së shkakut të vdekjes maternale, si dhe zhvillimin e aktiviteteve hulumtuese dhe digjitale në bashkëpunim me MSh, IKShPK, ASK, OBSH, UNICEF, UNFPA dhe MASHTI;
- Trajnime dhe aktivitete edukuese për shëndetin seksual dhe riprodhues, imunizimin dhe MISP, të destinuara për nxënës, profesionistë shëndetësorë dhe komunitete të ndryshme, përfshirë vizita në institucione parashkollore dhe qendra të mjekësisë familjare për promovimin e vaksinimit;
- Drafti final i planit të gatishmërisë për vaksinimin në masë gjatë pandemive respiratore, vizita në terren me fokus në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas për adresimin e sfidave të imunizimit, si dhe është dhënë kontributi në përgjigjen ndaj pyetësorëve institucionalë lidhur me vizitat shtëpiake dhe të drejtat e fëmijëve.

### 2.4.2 Divizioni për Promovim dhe Edukim Shëndetësor

Aktivitetet e divizionit janë përqëndruar në promovimin dhe edukimin shëndetësor përmes organizimit dhe shënimit të ditëve, javëve dhe fushatave ndërkombëtare të shëndetit sipas kalendarit të ditëve botërore:

- Në bashkëpunim me MSh dhe partnerë të tjerë (IKSHPK, AQH, IHS, OBSH, UNICEF, UNFPA, KOPF, institucione shkollore dhe media), është bërë koordinimi, hartimi, miratimi dhe shpërndarja e materialeve edukative dhe promovuese për tema kyçe si: kanceri i qafës së mitrës dhe i gjirit, kanceri i fëmijëve, tuberkulozi, diabeti, HIV/AIDS,

hipertensioni, fruthi, duhani, drogat, shëndeti oral, obeziteti, sindroma Down, sëmundjet e rralla, AMR, shëndeti mendor, shëndeti seksual dhe riprodhues, gjidhënia, mbrojtja e të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara, mbrojtja nga kafshimi i gjarpërinjve, zjarret e shkaktuara si pasojë e temperaturave të larta, hepatiti, parandalimi i vetëvrasjes, ndihma e parë, siguria e pacientëve, aksidentet në trafik;

- Ligjërata, sesione informuese dhe aktivitete vetëdijësuese në institucione shëndetësore, arsimore dhe komunitete, përfshirë Klinikën e Gjinekologjisë, spitalet rajonale dhe komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.
- Hartimi i Planit të Veprimit për Promovim dhe Edukim Shëndetësor 2026–2028, dhe Të ushqyerit e shëndetshëm, pjesëmarrja në punëtori për plane të veprimit dhe trajnime: shëndeti oral, vaksinimi kundër fruthit, komunikimi i avancuar, këshillimi motivues.
- Aktivitete mediatike në RTK, mirëmbajtje e ueb-faqes dhe Facebook-ut të IKShPK-së adresimi i rritjes së rasteve me HIV/AIDS, përgatita e videove dhe materialeve për “Matjen e kënaqshmërisë së pacientëve në tri nivelet shëndetësore”.
- Përpilimi i matricës për “PV të PESH 2023-2025” dhe PV të “Spitaleve të Shëndetshme 2025-2026” (Pejë dhe Gjakovë).

Gjatë vitit 2025 janë shënuar 13 ditë botërore të shëndetit, me realizimin e 966 ligjëratave me 43,393 pjesëmarrës dhe fushatave me 47,561 pjesëmarrës, gjatë të cilave u shpërndanë 112,821 materiale (tabela 17).

**Tabela 17. Aktivitetet e promovimit dhe edukimit shëndetësor, janar-dhjetor 2025**

Institucioni	Takime të KESH	Trajnimet		Ligjerata		Shëni mi i ditëve Nr i fushatave	Distribuimi i materialeve				Gjithsej	
		Nr i trajnimeve	Nr i pjesëmarrësve	Nr i ligjeratave	Nr i pjesëmarrësve		Fletëpalosje	Poster	Broshurë	Tjetër	Nr i pjesëmarrësve	Nr i materialeve
IKSHPK/QRSH Prishtinë	10	17	501	315	8,510	13	43,720	650	5,100	840	9,724	50,945
QRSH-Gjakovë	10	1	20	136	5,347	12	5,795	95	1,000	560	4,145	6,350
QRSH-Mitrovicë	10	5	107	160	3,047	11	4,740	385	15,287	1,485	9,720	21,291
QRSH Prizren	7	0	0	16	1,125	5	4,285	270	2,000	0	1,175	2,160
QRSH Gjilan	10	3	250	111	5,034	10	7,550	290	4,660	165	4,744	12,770
QRSH Pejë	10	0	0	152	18,237	12	13,600	610	3,300	350	14,213	16,740
QRSH Ferizaj	10	6	90	76	2,093	11	12,375	305	920	680	3,840	2,565
<b>Gjithsej</b>	<b>10</b>	<b>32</b>	<b>968</b>	<b>966</b>	<b>43,393</b>	<b>13</b>	<b>92,065</b>	<b>2,605</b>	<b>32,267</b>	<b>4,080</b>	<b>47,561</b>	<b>112,821</b>

Në Tabelën 18 janë paraqitur temat e ligjëruara për promovim dhe edukim shëndetësor gjatë periudhës janar–dhjetor 2025. Nga gjithsej 966 ligjërata të mbajtura me temat e paraqitura në tabelë, janë realizuar edhe 650 ligjërata me tema të tjera, si: parandalimi të sëmundjeve kardiovaskulare- zemrës, kanceri i gjirit, diabeti, gjidhënia, fruthi, hipertensioni, diare, gripi sezonal, temperaturat e larta, dieta, higjena orale, higjena personale, tuberkuloza, epilepsia, astma, shëndeti seksual dhe riprodhues.

**Tabela 18. Temat e ligjëruara për promovim dhe edukim shëndetësor, 2025**

Institucioni	Temat										
	Duhanpirja	Narkomania	Alkooli	HIV/AIDS	Aktiviteti fizik	Dhuna	Aksidentet në komunikacion	Shëndeti seksual dhe riprodhues/keshillim motivues	Kqushqyeshmëria	Tjetër (shënoni):	Totali i ligjëratave me tema të realizuara
IKSHPK/QRSHP Prishtinë	37	29	29	12	10	0	0	10	0	188	315
QRSHP-Gjakovë	7	1	0	12	0	0	0	0	0	116	136
QRSHP-Mitrovicë	12	12	12	23	11	0	0	1	2	87	160
QRSHP Prizren	0	0	0	0	0	0	0	0	0	16	16
QRSHP Gjilan	13	7	3	4	8	5	8	0	5	58	111
QRSHP Pejë	10	0	0	4	6	0	0	0	0	132	152
QRSHP Ferizaj	6	2	0	15	0	0	0	0	0	53	76
<b>Gjithsej</b>	<b>85</b>	<b>51</b>	<b>44</b>	<b>70</b>	<b>35</b>	<b>5</b>	<b>8</b>	<b>11</b>	<b>7</b>	<b>650</b>	<b>966</b>

### 2.4.3 Divizioni për mbështetjen e zhvillimit të UK dhe PK dhe cilësisë

Aktivitetet kryesore në këtë divizion janë përqëndruar në organizimin e takimeve dhe përgatitjen e materialeve përcjellëse për adaptimin e UK dhe PK, si dhe pjesëmarrjen në projekte e punëtori të lidhura me cilësinë:

- Gjatë periudhës raportuese, aktivitetet janë përqëndruar në koordinimin, zhvillimin dhe monitorimin e Udhërrëfyesve dhe Protokolleve Klinike (UK/PK), cilësinë dhe performancën në shëndetësi.
- Takime me kryesuesit e Grupeve të Punës për adaptimin e UK dhe PK, përgatitjen e raporteve mujore, si dhe formimin e grupeve për KKUPK për trajnimet e UPK 2025.
- Raporte tremujore të Performancës 2025 dhe është protokolluar Raporti i Performancës dhe i arriturave të IKShPK-së, si dhe është përgatitur Plani i Performancës 2026.
- Një fokus i veçantë i punës ka qenë hulumtimi “Matja e kënaqshmërisë së pacientit në kujdesin shëndetësor ambullantorik dhe spitalor në Kosovë”, për të cilin janë realizuar përgatitjet, aplikimi dhe marrja e pëlqimit nga Komisioni Etik në FM, përgatitja e draft qarkores, finalizimi i materialeve promovuese dhe angazhime të vazhdueshme për implementim. Në kuadër të këtij projekti janë organizuar dhe realizuar trajnime, përfshirë trajnimin mbi Audit Klinik më 15–17 dhjetor, si dhe trajnimin me 76 pjesëmarrës (14 nga spitalet rajonale dhe 62 nga QKUK).
- Kontributi në hartimin e PSO për monitorimin e zbatimit të UPK-ve, mbajtjen e prezantimeve për specialistët e MF mbi rolin e Divizionit në zhvillimin e UPK-ve dhe cilësinë, emërtimin e koordinatorëve të cilësisë në ISHP dhe IKShPK, pjesëmarrjen në punëtori mbi Auditet Klinike, Indikatorët Kyç të Performancës dhe vizitat në shtëpi.
- Takime pune me MSh, IHS, AQH, Banka Botërore, KKUPK dhe GlobalCT, si dhe angazhime lidhur me RVV për programin Master Shëndet Publik, duke kontribuar në forcimin e sistemit të cilësisë dhe performancës në shëndetësi.

#### **2.4.4 Divizioni për Moshimin**

Aktivitetet kryesore në këtë divizion janë përqëndruar në analizën e morbiditetit dhe përgatitja e masave të rekomanduara, trajnimet dhe pjesëmarrja në punëtori e hulumtime për shëndetin e personave të moshuar:

- Gjatë periudhës raportuese, aktivitetet kanë qenë të përqëndruara në përgatitjen dhe analizën e të dhënave për të moshuarit 65+ në Kosovë, për raportin “Analiza e morbiditetit tek të moshuarit mbi 65 vjeç në Kosovë për vitin 2022-2023”.
- Analiza e të dhënave demografike për të moshuarit 65+ sipas rezultateve të Regjistrimit të Popullsisë 2024 (ASK).
- Përgatitja e abstrakteve dhe prezantimeve për Konferencën e IV-të të PESH.
- Monitorimi i trajnimit të infermierëve dhe kujdestarëve informalë në kujdesin shtëpiak, ushtrime simuluse për QOESHp dhe aktivitete për Ditën Botërore të Shëndetit dhe Ditën Ndërkombëtare të Personave të Moshuar, përfshirë ligjërata, materialet promovuese dhe postime në rrjetet sociale.
- Koordinimi i hulumtimit “Literacia shëndetësore dhe sëmundjet kronike te të moshuarit” dhe 4 trajnime njëditore për mjekët dhe infermierët e KPSH-së mbi kujdesin ndaj pacientëve të moshuar, përfshirë ligjërata për shëndetin mendor në OJQ “Vita Jeta” dhe “Pojata”.

#### **2.4.5 Divizioni për Planifikim dhe Vlerësim Shëndetësor**

Ky divizion është në pritje të plotësimit të stafit.

#### **2.4.6 Divizioni për Programe të Veçanta**

Ky divizion është në pritje të plotësimit të stafit.

#### **2.4.7 Aktivitetet tjera**

Aktivitetet tjera të realizuara në DMS janë përqëndruar në analizën e gjendjes shëndetësore të popullatës, përgatitja dhe shqyrtimi i dokumenteve strategjike dhe planeve, pjesëmarrje në konferenca, përgatitje e raporteve, angazhimi në procesin e rregullt mësimor, mentorim profesional si dhe aktivitete të ngjashme:

- Aplikimi dhe projekti për hulumtimin INTERSECT-Traumat e lidhura me procesin e lindjes, GP për drejtësinë tranzicionale.
- Bashkëpunimi me OBSH për raportin e mbrojtjes financiare dhe shqyrtimi i dokumenteve për planin vjetor 2025 kanë vazhduar gjatë gjithë vitit.
- Finalizimi i analizës së gjendjes shëndetësore për vitin 2023 dhe përgatitja e profileve shëndetësore të Ferizajt dhe Prishtinës, abstrakteve, prezantimeve orale dhe posterëve për Konferencën IV të PESH.
- Finalizimi i udhëzimeve administrative për Kujdesin Parësor Shëndetësor, kryerja e intervistave për identifikimin e rreziqeve në vendin e punës, planifikimi i personelit për vitin 2026, rishikimi i Ligjit për Shëndetësi Publike dhe përgatitja e Kalendarit të IKShPK për vitin 2026.
- Hulumtime të realizuara, duke përfshirë hulumtimin mbi institucionet ekzistuese publike dhe private që ofrojnë trajtim psikosocial për viktimat e krimit gjatë luftës, GYTS në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta, hulumtimi i pilotimit të platformës digjitale Patrolla e imunizimit.

- Në fushën e publikimeve dhe komunikimit profesional, janë përgatitur artikuj për revistën Mjeku dhe Revistën Shëndeti të IKShPK.
- Organizimi i 100-vjetorit të IKShPK-së, duke përfshirë simpoziumin e 13<sup>të</sup> Concha Colomer, Konferencën e IV<sup>të</sup> Rajonale për Promovim dhe Edukim Shëndetësor, Shkolla Verore e 34<sup>të</sup> e ETC-PHHP në Kosovë, pjesëmarrje në nëngrupet punuese për aktivitete sportive, rregullim të oborrit, përpilimin e albumit të punëtorëve, monografinë, përgatitjen e pullës postare dhe të tjera.
- Organizimi i vizitave sistematike në QKMP Gjakovë dhe koordinimi i vizitave mjekësore për stafin e IKShPK dhe QRShP.
